

2025

**KËSHILLAT RINORË**

# Themelimi dhe menaxhimi i këshillave rinorë: Doracak



Organization for Security and  
Co-operation in Europe  
Mission in Kosovo





2025

**KËSHILLAT RINORË**

# **Themelimi dhe menaxhimi i këshillave rinorë: Doracak**



Organization for Security and  
Co-operation in Europe  
**Mission in Kosovo**





# Përmbajtja

<b>Parathënie</b>	<b>9</b>
<b>HYRJE</b>	<b>11</b>
<b>KAPITULLI I PARË: CILAT JANË NDRYSHIMET?</b>	<b>13</b>
<b>KAPITULLI I DYTË: SI TË THEMLOHET KËSHILLI QENDROR RINOR?</b>	<b>16</b>
Cilat janë rolet dhe përgjegjësitë e Këshillit Qendror Rinor?	<b>16</b>
Cila është struktura e Këshillit Qendror Rinor?	<b>17</b>
Udhëzime hap pas hapi për themelimin e Këshillit Qendror Rinor	<b>21</b>
Si të themelohet Asambleja?	<b>21</b>
Si të themelohet Këshilli Qendror Rinor?	<b>23</b>
Si të zgjidhet Kryesia?	<b>24</b>
Si të kërkohet mbështetje teknike dhe financiare për Këshillin Qendror Rinor?	<b>24</b>
<b>KAPITULLI I TRETË: SI THEMLOHEN KËSHILLAT LOKALË RINORË?</b>	<b>26</b>
Cilat janë rolet dhe përgjegjësitë e këshillave lokalë rinorë?	<b>26</b>
Cila është struktura e Këshillit Rinor Lokal?	<b>27</b>
Udhëzime hap pas hapi për themelimin e këshillave lokalë rinorë	<b>31</b>
Si themelohen Asambletë?	<b>31</b>
Si themelohen këshillat lokalrinor?	<b>33</b>
Si zgjidhet Kryesia?	<b>34</b>
Si të kërkohet mbështetje teknike dhe financiare për këshillat lokalë rinorë?	<b>34</b>
<b>SHTOJCAT</b>	<b>36</b>



# Shkurtesat

<b>AZHR</b>	Agjencia për Zhvillim Rinor
<b>OSHC</b>	Organizatë e shoqërisë civile
<b>KQVR</b>	Këshilli Qendrori Veprimit Rinor
<b>KQR</b>	Këshilli Qendror Rinor
<b>KVRL</b>	Këshilli i Veprimit Rinor Lokal
<b>KLR</b>	Këshilli lokal rinor
<b>MSR, Ministria</b>	Ministria e Sportit dhe Rinisë
<b>OSBE</b>	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë





# Parathënie

Prej kohësh Misioni i OSBE-së në Kosovë e ka kuptuar një të vërtetë të thjeshtë, por të fuqishme: kur përfshihen të rinjtë, shoqëritë bëhen më të forta, më të drejta dhe më të qëndrueshme. Të rinjtë nuk janë vetëm përfitues të politikave dhe programeve - ata janë partnerë, inovatorë dhe liderë, idetë dhe energjia e të cilëve formësojnë të ardhmen. Pjesëmarrja e tyre nuk mund të jetë opsionale, sepse është thelbësore për ndërtimin e komuniteteve demokratike, gjithëpërfshirëse dhe paqësore.

Këtë vit, teksa shënojmë 50-vjetorin e Aktit Final të Helsinkit, dhe 10-vjetorin e Agjendës globale për rininë, paqen dhe sigurinë, Misioni i OSBE-së në Kosovë riafirmon me krenari zotimin e tij të qëndrueshëm për ta bërë pjesëmarrjen e të rinjve kuptimplote ,pjesëmarrje me ndikim real në vendimmarrje dhe në përmirësimin e jetës.

Gjatë dy dekadave të fundit, Misioni ka punuar ngushtë me të rinjtë, institucionet dhe komunitetet për t'i ndërtuar themelet e demokracisë pjesëmarrëse në Kosovë. Nga mbështetja e Këshillave të parë Lokalë të Veprimit Rinor deri te ndihma në hartimin e legjislacionit dhe kornizave të politikave rinore të Kosovës, qasja jonë ka qenë gjithëpërfshirëse, duke kombinuar reformën e politikave, ngritjen e kapaciteteve, zhvillimin institucional dhe fuqizimin e komuniteteve.

Miratimi i ligjit të ri për rininë është po ashtu hap i rëndësishëm përpara. Ligji krijon një arkitekturë më të qartë dhe më gjithëpërfshirëse për angazhimin e të rinjve në nivel qendror dhe lokal, duke vënë në pah llogaridhënien, shumëllojshmërinë dhe bashkëpunimin ndërsektorial. Përmes përfshirjes aktive në konsultime publike dhe mbështetjes teknike për Ministria e Sportit dhe Rinisë, Misioni ka ndihmuar që ky kuadër i ri t'i pasqyrojë zërat dhe dëshirat për qëllimet e vetë të rinjve.

Ky doracak për themelimin dhe menaxhimin e këshillave rinorë ndërtohet mbi këtë zhvillim. Në të ofrohen udhëzime praktike dhe konkrete për ta shndërruar ligjin në veprim, duke siguruar kështu që këshillat rinorë të jenë demokratikë, transparentë, përfaqësues dhe të qëndrueshëm.

Duke mbështetur këtë proces, Misioni i OSBE-së në Kosovë thekson bindjen e tij se të rinjtë nuk janë vetëm e ardhmja, por edhe e tashmja. Janë shtytës i ndryshimeve, që meritojnë zë në formësimin e politikave që i prekin ata. Përmes angazhimit të vërtetë, përgjegjësisë së përbashkët dhe partneritetit, ne mund të vazhdojmë të ndërtojmë një Kosovë ku çdo i ri ka mundësi të marrë pjesë, të kontribuojë dhe të udhëheqë në krijimin e një shoqërie më përfshirëse dhe më demokratike.

**Ambasadori Gerard McGurk**  
**Shef i Misionit të OSBE-së në Kosovë**





# Hyrje

## Cili është qëllimi i këtij doracaku?

Këshillat rinorë luajnë rol thelbësor në forcimin e qeverisjes demokratike, zhvillimit të komunitetit dhe vendimmarrjes gjithëpërfshirëse në nivel qendror dhe lokal. Shërbejnë si mekanizëm i strukturuar për të rinjtë për artikullimin e nevojave të tyre, pjesëmarrjen në diskutimet e politikave dhe për të dhënë kontributin e tyre për një jetë publike më të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse. Duke i sjellë perspektivat e të rinjve në jetën publike dhe duke siguruar pjesëmarrjen e tyre në proceset vendimmarrëse, këshillat rinorë ndihmojnë që vendimet t'i pasqyrojnë këndvështrimet e ndryshme, të mbështesin angazhimin qytetar dhe të nxisin një kulturë llogaridhënieje dhe dialogu ndërmjet institucioneve dhe të rinjve.

Qëllimi kryesor i këtij doracaku është të ofrojë mbështetje të strukturuar dhe praktike për themelimin dhe funksionalizimin efektiv të Këshillit Qendror Rinor (KQR) dhe këshillave lokalë rinorë (KLR). Ai ofron udhëzime hap pas hapi, si dhe shpjegime të qarta të kornizave përkatëse të politikave, si dhe atyre ligjore dhe rregullatore. Fokus të veçantë ka ndihma në procesin e krijimit të këshillave rinorë, duke siguruar që ky proces të jetë gjithëpërfshirës, transparent dhe në përputhje me parimet e pjesëmarrjes demokratike.

## Si u hartua doracaku?

Doracaku është hartuar duke aplikuar metodologji pjesëmarrëse dhe të bazuar në dëshmi, gjatë periudhës mars–maj 2025, duke kombinuar analizën ligjore, angazhimin e palëve të interesit dhe aktivitetet në terren. Fillimisht është realizuar shqyrtim i thelluar i dokumenteve për të analizuar [Ligjin nr. 08/L-264 për rininë \(2024\)](#),<sup>1</sup> [Rregulloren \(MSR\) nr. 09/2024 për këshillat rinorë](#),<sup>2</sup> dhe dokumente strategjike relevante, si [Strategjia për rininë 2024–2032](#),<sup>3</sup> duke i identifikuar zbrazëtitrat dhe duke shndërruar përmbajtjen ligjore në udhëzime të zbatueshme dhe miqësore për të rinjtë. Më pas, u realizua anketë në internet me 40 përgjigje,<sup>4</sup> duke përfshirë të rinj, zyrtarë komunalë dhe OSHC, për të mbledhur të dhëna mbi nivelin e njohurive dhe nevojave për zbatim. Për të kuptuar më mirë rrethanat, u mbajtën gjashtë takime informuese në 26 komuna<sup>5</sup>, duke angazhuar mbi 100 palë të interesit, përfshirë aktivistë rinorë, ish-këshilla të veprimit rinorë lokalë (KVRL), këshilla studentorë dhe zyrtarë për rini. Këto takime, të bashkëorganizuara me Departamentin e Rinisë në Ministrinë e Sportit dhe Rinisë (Ministria, MSR), pasqyruan realitetet lokale, identifikuan sfidat dhe nxorën në pah praktikatat e mira. Trekëndëshi i gjetjeve ligjore, sasiore dhe cilësore ,përbën bazën e këtij doracaku, duke siguruar që ai të jetë i bazuar në kontekstin rinor dhe i përshtatur sipas nevojave të atyre që janë drejtpërdrejt të përfshirë në themelimin e këshillave rinorë.

<sup>1</sup> Ligji nr. 08/L-264 për rininë, në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=95847>

<sup>2</sup> Rregullorja (MSR) nr. 09/2024 për Këshillat Rinorë, në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=100111>

<sup>3</sup> Strategjia për rininë 2024-2032, në dispozicion në:

[https://www.mkrs-ks.org/repository/docs/STRATEGJIA\\_SHTETERORE\\_PER\\_RINI\\_2024-2032\\_EN.pdf](https://www.mkrs-ks.org/repository/docs/STRATEGJIA_SHTETERORE_PER_RINI_2024-2032_EN.pdf)

<sup>4</sup> Demografia e të anketuarve: 62% burra dhe 38% gra; 57% shqiptarë; 10% serbë; 8% romë, ashkali dhe egjiptianë; dhe 5% turq. Shpërndarja sipas moshës tregon se 75% ishin mbi 30 vjeç, 15% ishin 19-29 vjeç dhe 10% ishin 25-29 vjeç.

<sup>5</sup> Ferizaj, Kaçanik, Hani i Elezit, Prishtinë, Lipjan, Fushë Kosovë, Obiliq, Shtime, Graçanicë, Pejë, Gjakovë, Istog, Klinë, Prizren, Suharekë, Dragash, Rahovec, Malishevë, Glogoc, Mitrovicë e Jugut, Podujevë, Skenderaj, Vushtrri, Gjilan, Kamenicë

## Kujt i shërben ky doracak?

Ky doracak është hartuar për një gamë të gjerë të aktorëve të angazhuar në sektorin e rinisë. Përdoruesit kryesorë përfshijnë të rinjtë që synojnë të bëhen anëtarë të këshillit qendror dhe këshillave lokalë, zyrtarët komunalë për rini, si dhe stafin e Ministrisë dhe Agjencisë për Zhvillimin e Rinisë (Agjencia, AZHR). Ai u shërben edhe organizatave të shoqërisë civile që mbështesin angazhimin rinor, si dhe aktivistëve dhe punonjësve rinorë të përfshirë në pjesëmarrjen qytetare. Doracaku mbështet si aktorët institucionalë formalë ashtu edhe nismat rinore joformale, duke ofruar udhëzime të qasshme dhe praktike për të gjitha fazat e themelimit dhe funksionimit të këshillave rinorë. Qasja e doracakut me fokus te përdoruesi siguron që secili aktor t'i kuptojë rolet dhe përgjegjësitë e veta specifike, duke kontribuar kështu në infrastrukturë më koherente dhe gjithëpërfshirëse të pjesëmarrjes rinore në të gjitha nivelet e qeverisjes.

## Si përdoret doracaku?

Doracaku është i organizuar në mënyrë praktike, hap pas hapi, si dhe është lehtësisht i lexueshëm për përdorues të ndryshëm. Çdo pjesë i përgjigjet një faze ose komponenti të ndryshëm të zhvillimit të këshillave rinorë, duke filluar nga shpallja e thirrjeve publike dhe zgjedhja e anëtarëve, e deri te sigurimi i pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse dhe ruajtja e kujtesës institucionale. Lexuesit mund t'u referohen drejtpërdrejt kapitujve që kanë të bëjnë me rolin e tyre, qoftë si anëtarë të rinj që formojnë një këshill, si zyrtarë komunalë që lehtësojnë procesin, apo si aktorë të shoqërisë civile që mbështesin aktivitetet e ngritjes së kapaciteteve. Mjetet praktike dhe formularët e ofruar në Shtojca, si dhe rubrikat shpjeguese përgjatë tërë dokumentit, janë ofruar për t'i shndërruar detyrimet ligjore në hapa konkretë e të zbatueshëm. Derisa doracaku mund të përdoret në mënyrë lineare, ai mund të lexohet edhe në mënyrë modulare, që do të thotë se aktorët mund të konsultojnë kapituj ose shtojca specifike sipas nevojave të tyre specifike.

# KAPITULLI I PARË:

## Cilat janë ndryshimet?

Kuadri i ri i politikave dhe ai ligjor e rregullativ e pozicionojnë Këshillin Qendror Rinor dhe këshillat lokalë rinorë në qendër të një mjedisi bashkëpunues që përfshin institucionet qeveritare, administratat e pushtetit lokal, shoqërinë civile dhe siguron që zërat e të rinjve të mbështeten.<sup>6,7,8</sup>

Në thelb të këtij sistemi qëndron Agjencia e re për Zhvillimin e Rinisë, e cila është përgjegjëse për koordinimin e sektorit të rinisë, mbështetjen e këshillave dhe menaxhimin e certifikimit të punës vullnetare për ta njohur zyrtarisht angazhimin rinor. Kjo strukturë e shndërron pjesëmarrjen e të rinjve në forcë strategjike dhe të institucionalizuar që ndikon në politikat, arsimin dhe jetën komunitare.

Korniza e re ligjore rikoncepton rolet në tërë sektorin e rinisë: derisa sipas ligjit të mëparshëm, këshillat qendrorë dhe lokalë të veprimit rinor (KQVR dhe KLVR) funksiononin si organizata të regjistruara të shoqërisë civile, sipas ligjit të ri ato tani themelohen si grupe joformale. Ky ndryshim thekson rolin e tyre si partnerë strategjikë të institucioneve qeveritare, të cilat tani kanë detyrim ligjor për t'i angazhuar dhe mbështetur ato. Kjo strukturë e koordinuar e integron pjesëmarrjen rinore në qeverisje, me potencial për të nxitur besimin qytetar afatgjatë dhe

	Çka ka ndryshuar nga struktura e mëparshme?	Pse ato janë të rëndësishme për sektorin e rinisë?
<p><b>Këshilli Qendror Rinor:</b> Grup këshillues, avokues dhe monitorues për çështjet rinore, i cili shërben si platformë për bashkëpunimin ndërmjet Qeverisë, këshillave lokalë, organizatave rinore, organizatave për të rinjtë dhe grupeve joformale.<sup>9</sup></p> <p><b>Këshillat lokalë rinorë:</b> Ngjashëm me Këshillin Qendror Rinor, por me veprim në nivel komunal.<sup>10</sup></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Kalimi nga organizatë e regjistruar e shoqërisë civile në grup joformal;</li> <li>▪ Role dhe përgjegjësi të ridefinuara për fuqizimin e zërit të të rinjve;</li> <li>▪ Forcimi i rolit për pjesëmarrje në strukturat dhe proceset institucionale qendrore dhe lokale;</li> <li>▪ Mbështetje e drejtpërdrejtë për qeverisjen e brendshme.</li> </ul>	<p><b>Linjë e drejtpërdrejtë me qeverinë!</b> KQR u mundëson organizatave rinore dhe grupeve joformale t'i shprehin shqetësimet e tyre dhe të kontribuojnë në hartimin dhe zbatimin e politikave.</p> <p><b>Zëri juaj në nivelin lokal!</b> KLR-të janë thelbësore për adresimin e çështjeve specifike të komunitetit dhe për të siguruar që politikat lokale i pasqyrojnë nevojat e të rinjve.</p>

<sup>6</sup> Ligji nr. 08/L-264 për rininë, në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=95847>

<sup>7</sup> Rregullorja (MSR) nr. 09/2024 për këshillat rinorë, miratuar me Vendim të ministrit nr. 140/2024, datë 31.12.2024, në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=100111>

<sup>8</sup> Strategjia për rininë 2024-2032, në dispozicion në:

[https://www.mkrs-ks.org/repository/docs/STRATEGJIA\\_SHTETERORE\\_PER\\_RINI\\_2024-2032\\_EN.pdf](https://www.mkrs-ks.org/repository/docs/STRATEGJIA_SHTETERORE_PER_RINI_2024-2032_EN.pdf)

<sup>9</sup> Ligji nr. 08/L-264 për Rininë, neni 14 Këshilli Qendror i Rinisë


<sup>10</sup> Ligji nr. 08/L-264 për rininë neni 15 Këshillat lokalë rinorë



pjesëmarrjen demokratike.

Me ligjin i ri për rininë këshillat e mëparshëm lokalë të veprimit rinor dhe Këshilli Qendror i Veprimit Rinor zëvendësohen me këshillat lokalë rinorë dhe Këshillin Qendror Rinor, duke shënuar një zhvendosje nga angazhimi i bazuar në OSHC në model të strukturuar dhe të bazuar në të drejta të pjesëmarrjes rinore.

Këto këshilla tani kanë role të përkufizuara qartë, mandate të qarta ligjore dhe mbështetje institucionale për të ndikuar në politika, për t'i këshilluar autoritetet dhe për të monitoruar strategjitë rinore. Ky diagram ilustron tranzicionin institucional nga këshillat rinorë të mëparshëm (Këshillat qendrorë/lokalë të veprimit rinor) drejt këshillave të rinj rinorë (Këshillat Qendrorë/Lokalë Rinorë) të njohur dhe të rregulluar ligjërisht, duke paraqitur njëkohësisht rolin e vazhdueshëm të këshillave të mëparshëm si organizata aktive të shoqërisë civile.



## PSE TË BËHENI PJESË e Këshillit Qendror Rinor ose këshillave lokalë rinorë?

Pjesëmarrja qytetare është themelore për formësimin e së ardhmes së komuniteteve dhe shoqërisë. Të qenit pjesë e KQR-së ose KLR-ve ofron përfitime konkrete për vajzat dhe djemtë e rinj të moshës 15–29 vjeçe, për të kontribuar në proceset pjesëmarrëse të politikëbërjes dhe vendimmarrjes. Përmes këtyre proceseve, të rinjtë kanë mundësinë të shprehin zërin e tyre dhe t'i adresojnë në mënyrë efektive shqetësimet dhe sfidat që ndikojnë në jetën e tyre të përditshme. Nuk është vetëm mundësi për zhvillim personal, por edhe investim i fuqishëm në të ardhmen e tyre si anëtarë të përgjegjshëm dhe të përkushtuar të komunitetit dhe shoqërisë.

**Duke u bërë anëtarë të këshillave, të rinjtë mund të:**

- ✓ Kontribuojnë drejtpërdrejt në proceset e politikëbërjes dhe vendimmarrjes, duke siguruar që zërat e të rinjve ndikojnë si në nismat në nivel lokal ashtu edhe ato në nivel qendror;
- ✓ Ndërtojnë përvojë profesionale duke fituar shkathtësi praktike në: (i) monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të strategjive, politikave dhe legjislacionit; (ii) të folurit në publik; (iii) avokimin dhe ndërtimin e partneriteteve; dhe (iv) hartimin pjesëmarrës të politikave;
- ✓ Marrin certifikata për punën vullnetare përmes Këshillit Qendror Rinor ose këshillave lokalë rinorë, të lëshuara nga Agjencia dhe komunat; Përdorin këto certifikata si vlerë të shtuar për aplikime për bursa, praktika profesionale dhe vende pune;
- ✓ Kanë qasje në mundësi për ngritje kapacitetesh, si trajnime, vizita shkëmbimi dhe programe mentorimi të ofruara nga organizatat e shoqërisë civile, qeveria dhe partnerët ndërkombëtarë;
- ✓ Bëhen pjesë e diçkaje më të madhe ku, përmes pjesëmarrjes sistematike të garantuar me ligjin për rininë dhe rregulloren për këshillat rinorë, anëtarët kanë qasje të drejtpërdrejtë në proceset e nivelit qendror dhe lokal;
- ✓ Rrjetëzohen me vendimmarrës përmes takimeve të drejtpërdrejta dhe bashkëpunimit me zyrtarë komunalë, udhëheqës të shoqërisë civile, organizata ndërkombëtare dhe të rinj të tjerë aktivë;
- ✓ Avokojnë për komunitetin ku jetojnë të rinjtë, ngrisin shqetësime, propozojnë zgjidhje dhe kontribuojnë në ndërtimin e një qeverisjeje më gjithëpërfshirëse dhe më të përgjegjshme.

# KAPITULLI I DYTË: Si të themelohet Këshilli Qendror Rinor?

Këshilli Qendror Rinor promovon politika rinore gjithëpërfshirëse dhe me ndjeshmëri gjinore duke përfaqësuar në mënyrë aktive zërat e të rinjve, dhe duke avokuar për nevojat e tyre, këshilluar institucionet qendrore dhe lokale, monitoruar zbatimin e politikave, marrë pjesë në diskutime kyçe, koordinuar përpjekjet, propozuar zgjidhje inovative, raportuar mbi progresin dhe ndërtuar rrjete bashkëpunimi për të forcuar ekosistemin rinor.

## Cilat janë rolet dhe përgjegjësitë e Këshillit Qendror Rinor?

KQR luan rol kyç në përfaqësimin dhe avokimin për nevojat dhe interesat e të rinjve si në nivel qendror dhe në nivel lokal. Përgjegjësitë e tij janë të shumanshme dhe përfshijnë përfaqësimin, bashkëpunimin, vlerësimin e nevojave, avokimin për politika, mbështetjen e këshillave lokalë, mbledhjen e të dhënave, pjesëmarrjen në komisione kyçe, ndërtimin e partneriteteve dhe organizimin e ngjarjeve.

Si zëri kryesor i të rinjve, KQR ka për detyrë t'i **përfaqësojë të rinjtë** përballë institucioneve dhe trupave ndërkombëtare, duke siguruar barazi dhe përfshirje. Kjo përfshin pjesëmarrjen aktive në diskutime, paraqitjen e perspektivave rinore dhe avokimin për politika që adresojnë shqetësimet e të rinjve.

Mbi të gjitha, Këshilli Qendror Rinor duhet të mbajë marrëdhënie të ngushtë pune me Agjencinë, duke u koordinuar me mentorin e caktuar nga Agjencia, i cili ofron udhëzim, këshilla dhe ngritje kapacitetesh për anëtarët e këshillit. Ky mentorim siguron që anëtarët pajisen me kapacitete për t'i përmbushur në mënyrë efektive përgjegjësitë e tyre. KQR është gjithashtu përgjegjës për dorëzimin në kohë të planeve vjetore, kërkesave për shpenzime dhe raporteve pranë Agjencisë për Zhvillimin e Rinisë, duke siguruar transparencë dhe llogaridhënie.

Në bashkëpunim me mentorin e Agjencisë dhe këshillat lokalë rinorë, Këshilli Qendror Rinor **identifikon nevojat e të rinjve** dhe **harton plane veprimi** për të avancuar rolin e tyre si në nivel qendror ashtu edhe të lokal. Kjo përfshin zhvillimin e anketave, mbajtjen e konsultimeve, si dhe mbledhjen dhe analizimin e të dhënave për t'i kuptuar sfidat dhe mundësitë për të rinjtë.

KQR gjithashtu **këshillon** institucionet publike, **avokon** për çështjet rinore dhe **monitoron** zbatimin e politikave rinore, përfshirë Strategjinë për Rininë. Kjo nënkupton shqyrtimin e legjislacionit, pjesëmarrjen në konsultime publike dhe kërkimin e llogarisë nga qeveria për angazhimet e saj për të rinjtë.

Për më tepër, Këshilli Qendror Rinor **mbështet themelimin dhe funksionimin e këshillave lokalë rinorë**, mbledh të dhëna mbi funksionimin dhe aktivitetet e tyre dhe raporton për to pranë Agjencisë. Kjo siguron llogaridhënie që këshillat lokalë rinorë të jenë efektive në përfaqësimin e nevojave të të rinjve në nivel lokal.



Gjithashtu, Këshilli Qendror Rinor merr pjesë në takimet e Komisionit për Rininë, duke kontribuar në zhvillimin shumësektorial të politikave në sektorin e rinisë.

Së fundi, KQR **ndërton partneritete** ndërmjet organizatave rinore, institucioneve publike, sektorit privat dhe aktorëve ndërkombëtarë për të nxitur zhvillimin në fushën e rinisë. Ai organizon gjithashtu ngjarje dhe takime mbi çështjet rinore, përfshirë **konferencën vjetore me këshillat lokale rinorë**, duke ofruar platforma për diskutim, rrjetëzim dhe bashkëpunim.

## Cila është struktura e Këshillit Qendror Rinor?

Këshilli Qendror Rinor është i strukturuar në tri organe kryesore: Në krye është **kryesia e Këshillit Qendror Rinor**, e përbërë nga **kryetari, katër nënkryetarët**, dhe **sekretari**, përgjegjës për drejtimin dhe koordinimin e punës së Këshillit. Vetë Këshilli përfshin **21 përfaqësues të të rinjve** dhe shërben si trupi kryesor vendimmarrës i cili reflekton diversitetin e të rinjve. **Asambleja e Këshillit Qendror Rinor** bashkon një grup më të gjerë aktorësh, përfshirë përfaqësues nga organizatat rinore, organizatat për të rinjtë, unionet studentore, këshillat studentorë dhe forumet rinore të partive politike, duke siguruar pjesëmarrje dhe përfaqësim gjithëpërfshirës në dialogun dhe hartimin e politikave rinore.

Agjencia emëron **mentorin** për të mbështetur Këshillin Qendror Rinor. Mentori mund të jetë nëpunës civil nga Agjencia apo punëtor rinor. Mentori parësisht mbështet këshillin në procedurat e themelimit, hartimin e planit vjetor të punës, zbatimin e aktiviteteve, ngritjen e kapaciteteve dhe pjesëmarrjen, si dhe në çështje të tjera që kanë të bëjnë me përgjegjësitë e KQR-së. Nga ana tjetër, Këshilli Qendror Rinor emëron një komision tematik të ngarkuar me detyrën e mentorimit të këshillave lokale rinorë.

**Asambleja** e Këshillit Qendror Rinor përzgjedh anëtarët e KQR-së, miraton aktin e themelimit dhe ndërhyr në rast të mosfunksionimit të këshillit. Asambleja ka mandat trevjeçar (3), i cili fillon nga data e mbajtjes së mbledhjes konstituive. Vetëm anëtarët e Asamblesë mund të nominohen dhe të përzgjidhen për KQR.

**Këshilli Qendror Rinor** zgjedh kryetarin, nënkryetarët dhe sekretarin për të formuar kryesinë e KQR-së. Këshilli është organi kryesor që këshillon, avokon dhe monitoron politikat rinore, si dhe koordinon sektorin e rinisë. Numri maksimal i anëtarëve të KQR-së është 21. Ata kanë mandat trevjeçar (3), i cili fillon nga data e miratimit të aktit të themelimit nga Asambleja. Anëtarët mund të rizgjidhen për mandate pasuese, për sa kohë që i përkasin grupmoshës së përcaktuar.

**Kryesia e Këshillit Qendror Rinor** është organi më i lartë drejtues dhe përfaqësuesi i autorizuar i këshillit. Kryetari përfaqëson KQR-në në marrëdhëniet e jashtme, ndërsa Nënkryetarët kryesojnë komitetet. Kryesia mund të shkarkohet nga Asambleja me 50+1 për qind të votave të anëtarëve të saj, nëse ka kryer shkelje të rënda të detyrave të punës.

## Asambleja e Këshillit Qendror Rinor

- ✓ Përzgjedh anëtarët e Këshillit dhe miraton aktin zyrtar të themelimit;
- ✓ Mbikëqyr funksionimin e këshillit dhe ndërhyr në rastet e mosfunksionimit;
- ✓ Siguron përmbushjen e kriterëve të pranueshmërisë, duke kërkuar që vetëm anëtarët e Asamblesë të mund të nominohen dhe të përzgjidhen për KQR.

### Kryetari

- ✓ Organizon dhe kryeson së paku 4 mbledhje të KQR-së në vit;
- ✓ Siguron që plani vjetor i punës të hartohet me kohë dhe t'i përcillet Agjencisë;
- ✓ Nënshkruan aktet e miratuara nga Këshilli Qendror Rinor dhe siguron zbatimin e tyre;
- ✓ Siguron që KQR të funksionojë në përputhje me aktin e themelimit;
- ✓ Ndërmerr masa për zbatimin e planit vjetor të punës dhe vendimeve të dakorduara në mbledhjet e KQR-së;
- ✓ Përfaqëson Këshillin Qendror Rinor në marrëdhëniet e jashtme.

### Nënkryetarët

- ✓ Kryeson një nga komitetet e Këshillit. Njëri nga komitetet duhet të jetë përgjegjës për mentorimin e këshillave lokalë rinorë;
- ✓ Zëvendëson kryetarin në rast të mungese së tij/saj;
- ✓ Mbështet kryetarin në zbatimin e detyrave dhe përgjegjësi;
- ✓ Siguron zbatimin e aktiviteteve të komitetit.

### Sekretari

- ✓ Mbështet detyrat administrative të KQR-së;
- ✓ Planifikon mbledhjet dhe mban procesverbalet;
- ✓ Menaxhon komunikimin brenda KQR-së;
- ✓ Siguron që këshilli i ndjekë rregullat procedurale.

## Anëtarët e Këshillit Qendror Rinor

- ✓ Marrin pjesë në mbledhjet e këshillit;
- ✓ Propozojnë tema diskutimi dhe aktivitete;
- ✓ Marrin pjesë në vendimmarrje dhe ndërmarrin nisma për zbatimin e planit të punës së KQR-së;
- ✓ Kontribuojnë në hartimin e dokumenteve të këshillit;
- ✓ Marrin pjesë aktivisht në punën e komiteteve të KQR-së.

## Komitetet e Këshillit Qendror Rinor

- ✓ KQR mund të organizohet në komitete për t'i mbuluar të gjitha fushat me interes për sektorin e rinisë;
- ✓ Këshilli themelon së paku katër (4) komitete. Komiteti për mbështetjen e këshillave lokalë rinorë, si i vetmi komitet i paracaktuar që duhet të themelohet nga KQR, në qendër të vëmendjes ka mbështetjen dhe mentorimin e KLR-ve në aktivitetet dhe funksionimin e tyre. Fushëveprimi i komiteteve të tjera nuk përcaktohet me Rregullore dhe, varësisht nga relevanca, shembuj të mundshëm janë:
  - Komiteti për Politika dhe Avokim (fokuset në këshillimin e institucioneve publike, identifikimin e nevojave të të rinjve dhe avokimin për çështjet rinore. Siguron monitorimin e zbatimit të politikave);
  - Komiteti për Partneritete dhe Bashkëpunim (përgjegjës për krijimin e partneriteteve me institucionet qeveritare, OSHC-të, sektorin privat dhe organizatat ndërkombëtare);
  - Komiteti për Ngjarje dhe Konferenca (përgjegjës për organizimin e ngjarjeve, përfshirë konferencën vjetore rinore dhe takimet publike).
- ✓ Komitetet e këshillit mund të bazohen në strukturën e fushave sipas Strategjisë për Rininë.
- ✓ Komitetet e KQR-së udhëhiqen nga njëri prej nënkryetarëve, i cili siguron dokumentimin e punës dhe përfaqëson komitetin në takime brenda dhe jashtë këshillit, si dhe para institucioneve publike qendrore.

## Shpërbërja, përzgjedhja e anëtarëve të rinj dhe përfundimi i mandatit

Këshilli Qendror Rinor mund të shpërbëhet në dy mënyra:

- (1) Nëse Agjencia dokumenton mosfunksionimin e Këshillit, ajo i paraqet Asamblesë rekomandimin për shpërbërjen e tij.
- (2) Nëse të paktën 1/3 e anëtarëve të Asamblesë së Këshillit dokumenton mosfunksionimin e KQR-së, mund t'i paraqesin kërkesë Agjencisë për të iniciuar procesin e shpërbërjes.

***Në të dy rastet, KQR mund të shpërbëhet vetëm me vendimin e së paku 2/3 të anëtarëve të Asamblesë.***

Në rast të shpërbërjes së KQR-së, Asambleja përzgjedh anëtarët e rinj të Këshillit me mandat që zgjat **vetëm deri në përfundimin e mandatit fillestar** të Këshillit Qendror Rinor.

## Si përzgjidhen anëtarët e rinj?

Anëtarët e rinj të KQR-së përzgjidhen në rastet vijuese:

- Votim për shpërbërje para përfundimit të mandatit;
- Dorëheqja e një anëtari;
- Kur një anëtar e tejkalon moshën rinore para përfundimit të mandatit;
- Nëse Kryesia kërkon largimin e një anëtari për shkak të shkeljeve të rregullores së punës, si: mungesa e vazhdueshme e paarsyetuar në aktivitete dhe mbledhje të këshillit, shkelja e kodit të sjelljes dhe etikës, mosshmangia e konfliktit të interesit dhe/ose shkelja e parimit të besnikërisë ndaj këshillit. Largimi i një anëtari në këto raste mund të bëhet me vendimin e 2/3 të anëtarëve të Këshillit Qendror Rinor.

Të gjithë anëtarët e KQR-së duhet të marrin pjesë rregullisht në aktivitetet e këshillit. Në rast mungese, anëtari duhet ta njoftojë Kryesinë e KQR-së me shkrim për arsyen e mungesës. Nëse një anëtar mungon në tri (3) mbledhje radhazi të Këshillit, Kryesia ka të drejtë të kërkojë shkarkimin e anëtarit nga Këshilli.

Anëtarët e rinj përzgjidhen sipas **renditjes** në listën e plotë të rezultateve të zgjedhjeve, duke respektuar kërkesat për përfaqësim gjithëpërfshirës. Mandati i anëtarit të ri zgjat vetëm deri në përfundimin e mandatit të KQR-së.

## Çfarë ndodh pas përfundimit të mandatit?

- Së paku tre (3) muaj para përfundimit të mandatit të Këshillit Qendror Rinor, Agjencia ka për detyrë të iniciojë themelimin e Asamblesë së re sipas procedurave përkatëse.
- Anëtarët e Këshillit kanë të drejtë rizgjedhjeje për sa kohë që i përkasin grupmoshës së përcaktuar rinore.



# Udhëzime hap pas hapi për themelimin e Këshillit Qendror Rinor

## Kryesia e KQR-së

Kryetari  
Katër nënkryetarë  
Sekretari

## Këshilli Qendror Rinor

21 përfaqësues rinorë

## Asambleja e KQR-së

Përfaqësues të organizatave rinore, organizatave për të rinjtë, unioneve studentore, këshillave studentorë, forumeve rinore të partive politike



## Si themelohet Asambleja?

**HAPI I PARË:** Agjencia për Zhvillimin e Rinisë bashkëpunon me rrjetin e OSHC-ve për të themeluar Asamblenë e Këshillit Qendror Rinor. Ky duhet të jetë rrjeti më i madh ekzistues i OSHC-ve që ka mandat për të mbështetur bashkëpunimin OSHC-Qeveri. Në rast rrjeti i tillë nuk është i disponueshëm për bashkëpunim, Agjencia përzgjedh një organizatë tjetër të shoqërisë civile përmes një thirrjeje publike.

**HAPI I DYTË:** Agjencia, në bashkëpunim me OSHC-në partnere (qoftë rrjeti i OSHC-ve apo një OSHC tjetër), publikon thirrjen publike për aplikim për t'u bërë anëtar i Asamblesë së Këshillit Qendror Rinor.

**HAPI I TRETË:** OSHC-ja partnere promovon thirrjen, menaxhon procesin e aplikimit dhe merr pjesë në Komisionin për shqyrtim.

**HAPI I KATËRT:** Agjencia themelon Komisionin për shqyrtimin e aplikimeve.

### Përbërja e Komisionit?

- Dy përfaqësues nga OSHC-ja partnere;
  - Një përfaqësues nga Agjencia.

### Kush mund të aplikojë për anëtarësim në Asamblenë e Këshillit Qendror Rinor?

- Si përfaqësues, duhet të jetë i moshës 15–29 vjeç;
- Të ketë së paku dy (2) vite aktivitet të dëshmuar në sektorin e rinisë, të vërtetuar përmes një portofoli (unionet dhe këshillat studentore përjashtohen nga kjo kërkesë);
- Të jetë organizatë rinore ose organizatë për të rinjtë me së paku dy (2) vite regjistrim nga data e aplikimit (për OSHC-të), ose të ketë mandat zyrtar nga një universitet, shkollë apo parti politike (përkatësisht për unionet studentore, këshillat studentore dhe forumet rinore të partive politike).
- Ndonëse Këshilli Qendror Rinor nuk themelohet përmes KLR-ve, anëtarët e këshillave lokalë rinorë kanë të drejtë të nominohen dhe të zgjidhen në KQR, dhe po ashtu anëtarët e KQR-së mund të nominohen dhe të zgjidhen në KLR.

### Si aplikohet për anëtarësim në Asamblenë e Këshillit Qendror Rinor?

- Letra e motivimit (që përfshin përvojën, qëllimet dhe arsyen për t'u bërë pjesë e Asamblesë, si dhe të dhënat bazë të përfaqësuesit rinor të deleguar);
- Portofoli i aktiviteteve (i strukturës rinore delegeuse) (Shtojca 1);
- Certifikata e regjistrimit (për OSHC-të) ose njohja zyrtare nga universiteti, shkolla apo partia politike (për unionet studentore, këshillat studentorë dhe forumet rinore të partive politike);
- Rezume (CV) e përfaqësuesit të deleguar nga struktura rinore për anëtar të Asamblesë;
- Certifikata që dëshmon se përfaqësuesi nuk ka precedentë penalë.

*\*Nuk ka kufizim në numrin e anëtarëve të Asamblesë; të gjitha strukturat aplikuese që përmbushin kriteret bëhen pjesë e Asamblesë. Komisioni harton dhe publikon raportin me listën e strukturave të aprovuara dhe të refuzuara, si dhe arsyet e refuzimit, në faqen zyrtare të Agjencisë për Zhvillimin e Rinisë.*

*Sipas Rregullores, individët nuk mund të aplikojnë drejtpërdrejt në Asamblenë e KQR-së. Megjithatë, nëse i përmbushin kriteret, ata mund t'i drejtohen një organizate rinore, këshilli/unioni studentor ose forumi rinor partiak me të cilin kanë bashkëpunuar, për t'u nominuar.*

## Si themelohet Këshilli Qendror Rinor?

**HAPI I PARË:** Agjencia dhe OSHC-ja partnere mbështesin procesin e organizimit të mbledhjes konstituive të Asamblesë.

**HAPI I DYTË:** Agjencia u dërgon ftesën për mbledhjen konstituive të Asamblesë të gjithë anëtarëve të pranuar, së paku pesë (5) ditë para datës së mbajtjes së saj. Në rast se nuk ka kuorum (shumicë e thjeshtë), Agjencia dhe OSHC-ja partnere thërrasin mbledhje tjetër brenda 24 orëve.

**HAPI I TRETË:** Anëtarët e Asamblesë mund të vetënominojnë gjatë mbledhjes konstituive për t'u kandiduar për anëtarë të Këshillit Qendror Rinor. Ndonëse KQR nuk buron nga këshillat lokalë rinorë, anëtarët e KLR-ve kanë të drejtë të nominohen dhe të zgjidhen në KQR, dhe anasjelltas.

**HAPI I KATËRT:** Anëtarët e Asamblesë votojnë për kandidatët me votim të fshehtë (Agjencia siguron të gjitha fletëvotimet dhe materialet zgjedhore). Çdo anëtar i Asamblesë mund të votojë deri në pesë (5) kandidatë.

**HAPI I PESTË:** Këshilli Qendror Rinor themelohet nga kandidatët që marrin më së shumti vota. Gjatë përzgjedhjes merren parasysh kriteret e përfshirjes dhe përfaqësimit:

Së paku 30% e anëtarëve janë vajza dhe gra të reja;

Së paku 20% e anëtarëve u përkasin komuniteteve joshumicë;

Së paku 10% e anëtarëve janë persona me aftësi të kufizuara.

**HAPI I GJASHTË:** Agjencia për Zhvillimin e Rinisë dhe OSHC-ja partnere hartojnë procesverbalin e mbledhjes konstituive, listën e anëtarëve të zgjedhur të KQR-së dhe listën e rezultateve të zgjedhjeve.

**HAPI I SHTATË:** Këshilli Qendror Rinor i zgjedhur harton Aktin e Themelimit (Shtojca 3), i cili votohet dhe miratohet nga Asambleja gjatë mbledhjes konstituive.

**HAPI I TETË:** Agjencia harton njoftimin për njohjen e KQR-së dhe ia dërgon atë Ministrisë për miratim. Njoftimi duhet të përfshijë, në formë të shtojcave, Aktin e Themelimit të KQR-së, procesverbalin e mbledhjes konstituive të Asamblesë dhe listën e rezultateve të zgjedhjeve.

**HAPI I NËNTË:** Me nënshkrimin e vendimit për njohje nga ministri i sportit dhe rinisë, KQR merr njohjen zyrtare të themelimit të tij.

**KËSHILLA për mbledhjen konstituive:** Rekomandohet që mbledhja konstituive të zgjasë dy (2) ditë, në mënyrë që anëtarët e nominuar dhe/ose të vetë-nominuar të Asamblesë të kenë kohë të mjaftueshme për të prezantuar vizionin dhe qëllimet e tyre për t'u bërë pjesë e KQR-së, si dhe që KQR të ketë kohë për të hartuar Aktin e Themelimit (Shtojca 2).

## Si zgjidhet Kryesia?

**HAPI I PARË:** Brenda 15 ditëve nga fillimi i mandatit, Këshilli Qendror Rinor thërret mbledhjen e parë për zgjedhjen e Kryesisë së KQR-së (Shtojca 4).

**HAPI I DYTË:** Anëtarët e KQR-së kanë të drejtë të vetënominohen për Kryesi.

**HAPI I TRETË:** Kryetari, katër (4) nënkryetarët dhe sekretari i Këshillit Qendror Rinor zgjidhen me votim të hapur gjatë mbledhjes së parë.

**HAPI I KATËRT:** Nën udhëheqjen e Kryesisë, KQR harton dhe miraton rregulloren e punës (Shtojca 5).

**HAPI I PESTË:** Rregullorja e punës parasheh themelimin e deri në katër (4) komiteteve, secili i kryesuar nga një nënkryetar.

## Si të kërkohet mbështetje teknike dhe financiare për Këshillin Qendror Rinor?

### Mbështetja financiare nga Agjencia

**HAPI I PARË:** Këshilli harton planin vjetor të aktiviteteve (Shtojca 5). Aktivitetet duhet të jenë në përputhje me mandatin e KQR-së.

**HAPI I DYTË:** KQR dorëzon planin vjetor të aktiviteteve me buxhet në departamentin përkatës të Agjencisë.

**HAPI I TRETË:** Agjencia vepron si Sekretariat i Këshillit Qendror Rinor dhe është përgjegjëse jo vetëm për zhvillimin e aktiviteteve, por edhe për mbulimin e kostove të aktiviteteve të përcaktuara në planin vjetor. Kostot që mund të mbulojnë nga Agjencia për Zhvillimin e Rinisë janë:

- Kostot e organizimit të mbledhjes konstituive të Asamblesë;
- Kostot e organizimit dhe pjesëmarrjes në mbledhjet e rregullta të KQR-së (katër mbledhje të detyrueshme në vit);
- Shpenzimet ditore sipas legjislacionit në fuqi për udhëtime zyrtare;
- Kostot e organizimit dhe pjesëmarrjes në takime të tjera, siç parashihen në planin e aktiviteteve të KQR-së.

*\* KQR dorëzon kërkesat pranë Agjencisë për Zhvillimin e Rinisë për mbulimin e shpenzimeve të aktiviteteve nga plani vjetor së paku 15 ditë pune përpara.*

## Mbështetja financiare e jashtme

Këshilli Qendror Rinor mund të pranojë mbështetje financiare nga donatorë vendorë dhe ndërkombëtarë për aktivitetet e planifikuara ose aktivitete e atypëratyshme që janë në përputhje me mandatin dhe përgjegjësitë e KQR-së. Meqenëse KQR është grup joformal, procesi i aplikimit për mbështetje financiare të jashtme përfshin këto mundësi:

- (1) Aplikimi për mbështetje financiare si grup joformal, në rastet kur donatori e ofron këtë mundësi;
- (2) Aplikimi përmes OSHC-ve anëtare të KQR-së, të cilat bien dakord të aplikojnë në emër të KQR-së.
  - (a) Kur Këshilli identifikon nevojën ose mundësinë për të aplikuar për mbështetje financiare të jashtme, ai duhet të vendosë se cila OSHC anëtare do të aplikojë në emër të këshillit.
  - (b) OSHC-ja aplikuese duhet të ketë vendim të nënshkruar nga Presidenti i Këshillit, i cili i bashkëngjitet aplikimit për financim dhe konfirmon se aplikimi bëhet në emër të Këshillit Qendror Rinor.

**Raportimi:** Këshilli harton dhe dorëzon një raport vjetor narrativ dhe financiar mbi zbatimin e planit vjetor të aktiviteteve një herë në vit pranë Agjencisë. Raportet e njëjta u shpërndahen për informim edhe anëtarëve të Asamblesë së Këshillit Qendror Rinor.

# KAPITULLI I TRETË: Si themelohen këshillat lokalë rinorë?

Këshillat lokalë rinorë i fuqizojnë të rinjtë duke bërë që zëri i tyre të dëgjohej më shumë, duke i adresuar nevojat e tyre, duke këshilluar vendimmarrësit lokalë lidhur me aspekte të rëndësishme që lidhen me të rinjtë, duke mbikëqyrur programet rinore, duke prirë me nisma të reja, duke e përcjellë përparimin e shënuar dhe duke krijuar lidhje e partneritete që kontribuojnë në kultivimin e një mjedisi rinor dinamik.

## Cilat janë rolet dhe përgjegjësitë e këshillave lokalë rinorë?

KLR-të kanë rol vendimtar në përfaqësimin dhe promovimin e interesave të të rinjve në nivel lokal. Roli i tyre është i larmishëm dhe përfshin të qenit **zëri i rinisë**, bashkëpunimin me organizata tjera, **vlerësimin e nevojave**, **avokimin** për hartim dhe zbatim të politikave, përfshirjen e palëve përkatëse të interesit, ndihmën në menaxhimin e qendrave rinore, komunikimin ndërmjet grupeve të ndryshme dhe organizimin e ngjarjeve.

Në cilësinë e zërit kryesor të të rinjve në raport me komunën, këshillat lokalë rinorë i përfaqësojnë ata para organeve të pushtetit lokal, në përputhje me parimet e përfaqësimit dhe gjithëpërfshirjes. Kjo përfshin pjesëmarrjen në diskutime në kuvendin e komunës, paraqitjen e pikëpamjeve të të rinjve dhe avokimin për politika dhe vendime që adresojnë problemet me të cilat përballlet rinia.

Është me rëndësi të theksohet po ashtu bashkëpunimi i ngushtë i KLR-ve me Këshillin Qendror Rinor dhe pushtetin lokal, në funksion të bashkërendimit të përpjekjeve dhe ofrimit të informatave sipas nevojës. Ky partneritet siguron që këshillat lokalë rinorë të marrin mbështetjen dhe trajnimet e nevojshme për t'i ushtruar detyrat e tyre në mënyrë efektive. Po ashtu, KLR-të kanë përgjegjësinë që të dorëzojnë në komunë plane periodike, kërkesa buxhetore dhe raporte, duke siguruar në këtë mënyrë transparencë dhe llogaridhënie.

Bashkë me KQR-në dhe partnerët lokalë, KLR-të **identifikojnë nevojat e të rinjve** dhe hartojnë plane për përmirësimin e gjendjes së tyre në nivel lokal. Kjo përfshin realizimin e anketave, organizimin e diskutimeve dhe analizimin e të dhënave për të kuptuar sfidat dhe mundësitë për të rinjtë.

Krahas kësaj, këshillat lokalë rinorë i **këshillojnë** autoritetet lokale, **promovojnë** çështje që lidhen me rininë dhe **monitorojnë** se si po zbatohen politikat rinore. Kjo përfshin shqyrtimin e planeve lokale, pjesëmarrjen në diskutimet mbi politika dhe të siguruarit që komuna t'i përmbushë zotimet e saj ndaj të rinjve.

Për më tepër, KLR-të marrin pjesë në përzgjedhjen e OSHC-ve që do të menaxhojnë me qendrat rinore dhe në monitorimin e aktiviteteve të tyre, në bashkëpunim me drejtorinë përkatëse komunale për rini dhe Agjencinë për Zhvillimin e Rinisë. Në këtë mënyrë sigurohet që qendrat rinore t'u shërbejnë në mënyrë efektive nevojave të të rinjve në komunë. KLR merr gjithashtu pjesë në takimet e organizuara nga Këshilli Qendror Rinor, komuna dhe Agjencia, duke kontribuar në zhvillimin dhe zbatimin e

përgjithshëm të politikave rinore.

Në fund, këshillat lokalë rinorë lehtësojnë krijimin e partneriteteve ndërmjet organizatave rinore, pushtetit lokal, sektorit privat dhe organizatave ndërkombëtare, me synim mbështetjen e zhvillimit të të rinjve në komunë. Po ashtu, ata organizojnë ngjarje dhe takime për tema rinore, duke krijuar mundësi që të rinjtë dhe palët e interesuara të krijojnë kontakte, të shkëmbejnë ide dhe të bashkëpunojnë.

## Cila është struktura e këshillit lokal rinor?

Këshillat lokalë rinorë janë të strukturuar në atë mënyrë që të sigurohet njëkohësisht përfaqësim dhe udhëheqje efektive në nivel komunal. Në krye të çdo këshilli lokal rinor qëndron **kryesia**, që përbëhet nga **kryetari, dy nënkryetarë**, dhe **sekretari**. KLR ka në përbërje të tijën grup të anëtarëve, **numri i të cilëve duhet të jetë tek**, ndërsa **maksimumi nuk duhet ta kalojë një të tretën e numrit të ulëseve në kuvendit të komunës përkatëse, e minimumi të mos shkojë nën pesë anëtarë**. Këtë strukturë e përplotëson Asambleja e KLR-së, që përbëhet nga përfaqësues të organizatave rinore, organizatave që punojnë me dhe për të rinjtë, parlamenteve studentore, këshillave të nxënësve dhe forumeve rinore të partive politike. Qëllim kryesor i Asamblesë është zgjedhja e anëtarëve të këshillit, duke siguruar njëherazi që në vendimmarrjen dhe dialogun rinor në nivel lokal të përfshihen zëra sa më të larmishëm nga sektori rinor.

Këshilli Qendror Rinor ka përgjegjësinë të ofrojë mentorim për këshillat lokalë rinorë gjatë mandatit të tij. Për këtë qëllim, Këshilli Qendror Rinor emëron një komitet tematik që ka për detyrë të mentorojë këshillat lokalë rinorë. Mentorimi përfshin, por nuk kufizohet vetëm në procesin e themelimit, hartimin e planit vjetor të punës, zbatimin e aktiviteteve, ngritjen e kapaciteteve, pjesëmarrjen dhe/ose çështje tjera që lidhen me përgjegjësitë e KLR-ve.

**Asambletë** e këshillave lokalë rinorë bëjnë përzgjedhjen e anëtarëve të këshillave, miratojnë aktin e themelimit dhe ndërhyjnë në rastet e mosfunksionimit të këshillave lokalë rinorë. Asambletë kanë mandat trevjeçar, që fillon nga data e mbledhjes konstituive. Vetëm anëtarët e Asambleve mund të nominohen dhe të përzgjidhen anëtarë të këshillave lokalë rinorë.

**Këshillat lokalë rinorë** zgjedhin kryetarin, nënkryetarët dhe sekretarin për ta themeluar kryesinë e KLR-së. Këshillat janë organ kryesor që këshillon, avokon dhe monitoron politikën rinore, si dhe bashkërendon sektorin rinor. Mandati i këshillave është tre (3) vjet, duke filluar nga data e miratimit të aktit të themelimit nga Asambletë. Sipas Ligjit për rininë, anëtarët e këshillit lokal rinor mund të rizgjidhen për mandate të njëpasnjëshme, për aq kohë sa janë të moshës rinore të përcaktuar me ligj.

**Kryesia** e këshillit lokal rinor është përgjegjëse për drejtimin e punës së këshillit. Kryetari e përfaqëson këshillin në marrëdhëniet e jashtme, ndërsa nënkryetarët drejtojnë komitetet.



### Kryetari

- ✓ Organizon dhe kryeson të paktën katër (4) mbledhje të KLR-së në vit;
- ✓ Siguron që plani vjetor i punës të hartohet me kohë dhe t'i përcillet drejtorisë komunale përkatëse për rini;
- ✓ Nënshkruan aktet e miratuara nga KLR dhe siguron zbatimin e tyre;
- ✓ Siguron që këshilli lokal rinor të funksionojë në përputhje me aktin e themelimit;
- ✓ Merr masa për zbatimin e planit vjetor të punës dhe të vendimeve të miratuara në mbledhjet e KLR-së;
- ✓ E përfaqëson KLR-në në marrëdhëniet e jashtme.

### Nënkryetarët

- ✓ Kryesojnë një nga komitetet e këshillit lokal rinor;
- ✓ Zëvendësojnë kryetarin në rast mungese;
- ✓ E mbështesin kryetarin në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi;
- ✓ Sigurojnë zbatimin e aktiviteteve të komiteteve.

### Sekretari

- ✓ Mbështet detyrat administrative të KLR-së;
- ✓ Planifikon mbledhjet dhe mban procesverbalet;
- ✓ Menaxhon komunikimin e brendshëm të këshillit lokal rinor;
- ✓ Siguron që KLR t'u përmbahet rregullave procedurale.

### Anëtarët e këshillit lokal rinor

- ✓ Marrin pjesë në mbledhjet e këshillit;
- ✓ Propozojnë tema për diskutim dhe aktivitete;
- ✓ Marrin pjesë në vendimmarrje dhe ndërmarrin nisma për zbatimin e planit të punës së këshillit;
- ✓ Kontribuojnë në përpilimin e dokumenteve të këshillit;
- ✓ Marrin pjesë aktivisht në punën e komisioneve të këshillit.

## Komitetet e këshillit lokal rinor

- ✓ Këshilli mund të organizohet në komitete që mbulojnë fushë të ndryshme me interes për sektorin rinor në komunën përkatëse;
- ✓ Këshillat lokalë rinorë i themelojnë të paktën dy komitete, fushëveprimi i të cilave nuk është përcaktuar me rregullore. Në varësi të rrethanave në terren, që mund të ndryshojnë nga njëra komunë në tjetrën, shembuj të mundshëm të komiteteve mund të jenë:
  - Komiteti për politika dhe avokim (përqendrohet në këshillimin e institucioneve publike, identifikimin e nevojave të rinjve dhe avokimin për çështjet rinore. Siguron monitorimin e zbatimit të politikave);
  - Komiteti për ngjarje dhe partneritete (përqendrohet në bashkëpunimin me KLR-të, organizimin e ngjarjeve dhe krijimin e partneriteteve me institucione qeveritare, sektorin privat, OSHC-të dhe organizata ndërkombëtare).
- ✓ Komitetet e KLR-së mund të bazohen në fushat e parapara në Strategjinë për rininë dhe strategjitë lokale për sektorin e rinisë.
- ✓ Komitetet e këshillit lokal rinor udhëhiqen nga nënkryetari, i cili siguron evidentimin e punës dhe e përfaqëson komitetin në takimet brenda dhe jashtë KLR-së, si dhe në raport me institucionet publike qendrore.

## Asambleja e këshillave lokalë rinorë

- ✓ Përzgjedh anëtarët e KLR-së dhe miraton aktin zyrtar të themelimit.
- ✓ Mbikëqyr funksionimin e këshillit dhe ndërhyr në raste mosfunksionimi.
- ✓ Siguron përmbushjen e kriterëve për përzgjedhje, duke kërkuar që vetëm anëtarët e Asamblesë të mund të nominohen dhe zgjidhen për KLR-në.

## Shpërbërja, përzgjedhja e anëtarëve të rinj dhe përfundimi i mandatit

Ekzistojnë dy mënyra për shpërbërjen e këshillit lokal rinor:

- (1) Nëse drejtoria përkatëse për rini e komunës evidenton mosfunksionimin e këshillit, ajo i paraqet asamblesë rekomandim për shpërbërjen e tij.
- (2) Nëse asambleja dokumenton mosfunksionimin e KLR-së, dhe kjo mbështetet nga të paktën 1/3 e anëtarëve të Asamblesë, ajo mund t'i paraqesë kërkesë drejtorisë përkatëse komunale për rini për shpërbërjen e këshillit.

***Në të dy rastet, këshilli lokal rinor shpërbëhet me vendimin e të paktën 2/3 e anëtarëve të asamblesë.***

Në rast të shpërbërjes së këshillit lokal rinor, asambleja përzgjedh anëtarët e rinj të këshillit me mandat që zgjat **vetëm deri në përfundim** të mandatit të këshillit lokal rinor.

## Si përzgjidhen anëtarët e rinj?

Anëtarët e rinj të këshillit lokal rinor përzgjidhen në këto raste:

- Kur votohet shpërbërja para përfundimit të mandatit;
- Në rast dorëheqjeje të një anëtari;
- Kur një anëtar e kalon kufirin e përcaktuar të moshës rinore para përfundimit të mandatit;
- Kur kryesia kërkon shkarkimin e një anëtari për shkak të shkeljeve të rregullores së punës si p.sh. mungesa e vazhdueshme e paarsyetuar në aktivitete dhe mbledhje të këshillit lokal rinor, shkelja e kodit të sjelljes dhe etikës, mosshmangia e konfliktit të interesit dhe/ose shkelja e parimit të besnikërisë ndaj këshillit. Shkarkimi i një anëtari në raste të tilla mund të bëhet me vendim të 2/3 të anëtarëve të këshillit.

Të gjithë anëtarët e këshillit lokal rinor duhet të marrin pjesë rregullisht në aktivitetet e këshillit. Në rast mungese, anëtari duhet ta njoftojë kryesinë me shkrim për arsyen e mospjesëmarrjes. Nëse një anëtar mungon për tre mbledhje radhazi, kryesia ka të drejtë të kërkojë shkarkimin e tij/saj nga këshilli lokal rinor.

***Anëtarët e rinj përzgjidhen sipas renditjes në listën e plotë të rezultateve zgjedhore, duke i respektuar detyrimet për përfaqësim gjithëpërfshirës. Mandati i anëtarit të ri zgjat vetëm deri në fund të mandatit të këshillit lokal rinor.***

## Çka ndodh pas përfundimit të mandatit?

- Të paktën tre (3) muaj para përfundimit të mandatit të këshillit lokal rinor, drejtoria përkatëse komunale për rini ka detyrimin që të iniciojë themelimin e Asamblesë së re sipas procedurave në fuqi.
- Anëtarët e këshillit lokal rinor kanë të drejtë rizgjedhjeje për aq kohë sa janë të moshës rinore të përcaktuar me ligj.

# Udhëzime hap pas hapi për themelimin e këshillave lokalë rinorë

## Kryesia e KLR

Kryetari  
Dy nënkryetarë  
Sekretari

## këshillat lokalë rinorë

KLR përbëhet nga një numër tek anëtarësh, jo më shumë se 1/3 e numrit të anëtarëve të kuvendit të komunës përkatëse dhe jo më pak se pesë (5) anëtarë.

## Asambleja e KLR

Përfaqësues të organizatave rinore, organizatave që punojnë me dhe për të rinjtë, parlamenteve studentore, këshillave të nxënësve, forumeve rinore të partive politike



## Si themelohen asambletë?

**HAPI I PARË:** Drejtoria përkatëse komunale për rini, në bashkëpunim me Këshillin Qendror Rinor, shpall thirrjen publike për aplikime për anëtarësim në Asamble.

**HAPI I DYTË:** Drejtoria përkatëse komunale për rini e promovon thirrjen, menaxhon procesin e aplikimit dhe merr pjesë në komisionin për shqyrtimin e aplikimeve.

**HAPI I TRETË:** Këshilli Qendror Rinor e promovon gjithashtu thirrjen për aplikime dhe merr pjesë në komisionin për shqyrtimin e aplikimeve.

**HAPI I KATËRT:** Drejtoria përkatëse komunale për rini e njofton Agjencinë për Zhvillimin e Rinisë për iniciimin e procedurave për themelimin e Asamblesë të KLR-së.

**HAPI I PESTË:** Drejtoria përkatëse komunale për rini e themelon komisionin për shqyrtimin e aplikimeve.

### Kush bën pjesë në Komision?

- Dy (2) përfaqësues të KQR-së
- Një (1) përfaqësues nga drejtoria përkatëse komunale për rini

**HAPI I GJASHTË:** Në rastet kur KQR-ja nuk ka mandat dhe/ose refuzon të marrë pjesë në komision, drejtoria përkatëse komunale për rini fton dy (2) anëtarë të OSHC-ve për të qenë pjesë e Komisionit, duke siguruar që të mos ketë konflikt interesi. Komuna përkatëse i mbulon shpenzimet e pjesëmarrjes në komision për të gjithë anëtarët e jashtëm, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Kush mund të aplikojë për anëtarësim në Asamble?**

- (1) Përfaqësuesi i deleguar duhet të jetë i moshës 15 - 29 vjeç;
- (2) Të ketë të paktën dy (2) vjet veprimtarie të dëshmuar në sektorin e rinisë në komunën përkatëse, të vërtetuar përmes portofolit (parlamentet studentore dhe këshillat e nxënësve janë të liruara nga ky kriter);
- (3) Të jetë organizatë rinore ose organizatë për të rinjtë me të paktën dy vjet regjistrim nga data e aplikimit (për OSHC-të), të ketë mandat zyrtar nga universiteti, shkolla ose partia politike (për parlamentet studentore, këshillat e nxënësve dhe forumet rinore të partive politike);
- (4) Ndonëse Këshilli Qendror Rinor nuk themelohet përmes këshillave lokalë rinorë, anëtarët e KLR-ve kanë të drejtë të emërohen dhe të zgjidhen në KQR, dhe anëtarët e KQR-ve mund po ashtu të emërohen dhe të zgjidhen në KLR.

**Si aplikohet për anëtarësim në Asamble?**

- ◆ Letër motivimi (ku përshkruhet përvoja, qëllimet dhe arsyeja për të qenë pjesë e asamblesë dhe të dhënat bazë të përfaqësuesit të deleguar të të rinjve);
- ◆ Portofol i aktiviteteve të strukturës rinore deleguese (Shtojca 1);
- ◆ Certifikatë regjistrimi (për OSHC-të) ose njohje zyrtare nga universiteti, shkolla ose partia politike (për parlamentet studentore, këshillat e nxënësve dhe forumet rinore të partive politike);
- ◆ CV i/e përfaqësuesit të deleguar nga struktura rinore për të qenë anëtar i Asamblesë;
- ◆ Certifikatë se përfaqësuesi nuk ka dënime penalet.

*\* Nuk ka kufizim të numrit të anëtarëve të asamblesë dhe të gjitha strukturat aplikuese që i plotësojnë kriteret mund të bëhen pjesë e asamblesë. Komisioni harton dhe boton raportin që përmban listën e strukturave anëtarësimi i të cilave është miratuar, dhe të atyre që u është refuzuar me arsyet përkatëse të refuzimit.*

*\* Sipas Rregullores, personat fizikë nuk mund të aplikojnë drejtpërdrejt në asamblenë e KLR-së. Megjithatë, nëse i plotësojnë kriteret, ata mund t'i drejtohen një organizate rinore, këshilli të nxënësve/parlamenti studentor ose forumi rinor të një partie politike me të cilin kanë bashkëpunim për t'u emëruar.*

## Si themelohen këshillat lokale rinorë?

**HAPI I PARË:** Drejtoria përkatëse komunale për rini dhe Këshilli Qendror Rinor e mbështesin procesin e organizimit të mbledhjes konstituive të Asamblesë;

**HAPI I DYTË:** Drejtoria përkatëse komunale për rini u dërgon ftesën për mbledhjen konstituive të Asamblesë gjithë anëtarëve të pranuar, të paktën pesë ditë para datës së mbledhjes. Në rast se nuk ka kuorum (shumicë e thjeshtë) për mbledhjen konstituive, drejtoria përkatëse komunale për rini dhe KQR-ja thërrasin mbledhje tjetër brenda 24 orëve;

**HAPI I TRETË:** Anëtarët e Asamblesë mund të vetëmërohen gjatë mbledhjes konstituive së Asamblesë për të kandiduar për anëtarësim në këshillin lokal rinor. Ndonëse KLR-të, sipas përkufizimit, nuk janë në përbërjen e KQR-së, anëtarët e KLR-së kanë të drejtë të nominohen dhe të zgjidhen në KQR dhe anasjelltas;

**HAPI I KATËRT:** Anëtarët e asamblesë votojnë për kandidatët me votim të fshehtë (Agjencia për Zhvillimin e Rinisë siguron të gjitha fletëvotimet dhe materialet zgjedhore). Secili anëtar i asamblesë mund t'i votojë deri në pesë kandidatë;

**HAPI I PESTË:** KLR formohet nga kandidatët me numrin më të madh të votave. Gjatë përzgjedhjes merren parasysh parimet e gjithëpërfshirjes dhe përfaqësimit si në vijim:  
Të paktën 30 për qind e anëtarëve të jenë vajza dhe gra të reja;  
Drejtoria përkatëse komunale për rini përcakton standarde të përfaqësimit gjithëpërfshirës për komunitetet joshumicë dhe personat me aftësi të kufizuara, bazuar në të dhënat demografike përkatëse të komunës.

**HAPI I GJASHTË:** Drejtoria përkatëse komunale për rini, në bashkëpunim me KQR-në, përgatit procesverbalin e mbledhjes konstituive, listën e anëtarëve të zgjedhur të KLR-së dhe listën e rezultateve.

**HAPI I SHTATË:** Këshilli lokal rinor i zgjedhur harton aktin e themelimit (Shtojca 3), i cili votohet dhe miratohet nga asambleja.

**HAPI I TETË:** Drejtoria përkatëse komunale për rini përgatit njoftimin për njohjen e këshillit lokal rinor dhe të njëjtin ia përcjellë kryetarit të komunës për njohje. Njoftimi duhet të përmbajë në formë shtojcash aktin e themelimit të këshillit lokal rinor, procesverbalin e mbledhjes konstituive të Asamblesë dhe listën e rezultateve zgjedhore.

**HAPI I NËNTË:** Me nënshkrimin e vendimit të njohjes nga kryetari i komunës, KLR merr njohjen zyrtare të themelimit.

*Në rastet kur Këshilli Qendror Rinor nuk është themeluar akoma ose nuk është në gjendje të marrë pjesë në proces, rregullorja i lejon drejtorisë komunale për rini të angazhojë përfaqësues të OSHC-ve lokale për të mbështetur procesin e themelimit. Përzgjedhja e këtyre OSHC-ve duhet të bëhet në pajtim me procedurat ekzistuese komunale për themelimin e komisionit me anëtarë të jashtëm dhe të sigurohet transparencë, paanshmëri dhe shmangie e çfarëdo konfliktoje interesi. Kjo qasje siguron legjitimitetin e procesit të themelimit, në përputhje me parimet e gjithëpërfshirjes dhe përfaqësimit demokratik.*

**KËSHILLA për mbledhjen konstitutive:** Rekomandohet që mbledhja konstituive të zgjasë dy (2) ditë, në mënyrë që anëtarët e asamblesë të cilët vetëkandidohen të kenë kohë të mjaftueshme për të paraqitur vizionin dhe qëllimet e tyre për anëtarësim në KLR, si dhe që KLR-ja të ketë kohë të hartojë aktin e themelimit (Shtojca 2).

## Si zgjidhet kryesia?

**HAPI I PARË:** Brenda 15 ditëve nga fillimi i mandatit, këshilli lokal rinor thërret mbledhjen e parë për zgjedhjen e kryesisë së KLR-së (Shtojca 4).

**HAPI I DYTË:** Anëtarët e këshillit lokal rinor kanë të drejtë të vetëkandidohen për kryesi.

**HAPI I TRETË:** Kryetari, dy nënkryetarët dhe sekretari i këshillit lokal rinor zgjidhen me votim të hapur gjatë mbledhjes së parë.

**HAPI I KATËRT:** Nën udhëheqjen e kryesisë, këshillit lokal rinor harton dhe miraton rregulloren e punës (Shtojca 5).

**HAPI I PESTË:** Rregullorja e punës propozon krijimin e komiteteve të ndryshme, secili prej të cilëve kryesohet nga një nënkryetar.

## Si të kërkohet mbështetje teknike dhe financiare për këshillat lokalë rinorë?

### Mbështetja financiare nga drejtoria përkatëse komunale për rini

**HAPI I PARË:** këshillat lokalë rinorë hartojnë planin vjetor të aktiviteteve (Shtojca 6). Aktivitetet duhet të jenë në përputhje me mandatin e KLR-së.

**HAPI I DYTË:** këshillat lokalë rinorë e dorëzojnë planin vjetor të aktiviteteve, bashkë me buxhetin, në drejtorisë përkatëse komunale për rini.

**HAPI I TRETË:** Drejtoria përkatëse komunale për rini vepron si sekretariat i KLR-së dhe është përgjegjëse jo vetëm për mbështetjen e zhvillimit të aktiviteteve, por edhe për mbulimin e kostos së aktiviteteve të parapara me planin vjetor të aktiviteteve. Shpenzimet që mund të mbulohen nga komuna përkatëse janë:

- shpenzimet për organizimin e mbledhjes konstituive së asamblesë;
- shpenzimet për organizimin dhe pjesëmarrjen në mbledhjet e rregullta të këshillit lokal rinor (katër mbledhje të detyrueshme në vit);
- shpenzimet për mëditje sipas legjislacionit në fuqi në raste të udhëtimeve të gjata pune/zyrtare;
- shpenzimet për organizimin dhe pjesëmarrjen në takime të tjera, të parapara me planin e aktiviteteve të këshillit lokal rinor.

*\* Këshillat lokalë rinorë i paraqesin komunës kërkesat për mbulimin e shpenzimeve për aktivitetet nga plani vjetor i aktiviteteve të paktën 15 ditë pune përpara.*



## Mbështetja financiare e jashtme

këshillat lokalë rinorë mund të pranojnë mbështetje financiare nga donatorë vendorë dhe ndërkombëtarë për aktivitete të planifikuara ose për aktivitete ad-hoc që rrjedhin dhe zhvillohen në përputhje me përgjegjësitë e KLR-së. Meqenëse këshilli lokal rinor është grup joformal, procesi i aplikimit për mbështetje financiare të jashtme mund të realizohet në këto mënyra:

- (1) aplikim për mbështetje financiare si grup joformal, në rastet kur donatori ofron këtë mundësi;
- (2) aplikim për mbështetje financiare përmes organizatave anëtare të këshillit lokal rinor që pranojnë të aplikojnë në emër të KLR-së:
  - (a) Kur këshilli identifikon nevojën ose mundësinë për të aplikuar për mbështetje financiare të jashtme, ai duhet të vendosë për organizatën anëtare që do të aplikojë në emër të tij.
  - (b) OSHC-ja aplikuese duhet të ketë një vendim të nënshkruar nga kryetari i KLR-së, i cili i bashkëngjitet aplikimit dhe konfirmon se aplikimi bëhet në emër të KLR-së.

**Raportimi:** këshilli lokal rinor harton dhe i dorëzon një herë në vit drejtorisë përkatëse komunale për rini raport vjetor narrativ dhe raport financiar mbi zbatimin e planit vjetor të aktiviteteve. Të njëjtat raporte i përcillen edhe asamblesë për informim.

# SHTOJCAT

[Rregullorja \(MSR\) nr. 09/2024 për Këshillat Rinorë](#) i përmban gjithsej nëntë (9) shtojca, që shërbejnë si materiale mbështetëse për Agjencinë për Zhvillimin e Rinisë, drejtoritë komunale për rini, OSHC-të, Këshillin Qendror Rinor dhe këshillat lokalë rinorë për ta zbatuar rregulloren.

- [Shtojca 1: Akti i themelimit të KQR dhe KLR](#)
- [Shtojca 2: Model rregullore e punës së Këshillit Qendror Rinor/Lokal Rinor të komunës](#)
- [Shtojca 3: Procesverbali i mbledhjes së asamblesë konstituive për themelimin e këshillit qendror/lokal Rinor](#)
- [Shtojca 4: Vendimi për njohjen e këshillit qendror/lokal Rinor](#)
- [Shtojca 5: Lista e anëtarëve rezervë për Këshillin Qendror/Lokal Rinor](#)
- [Shtojca 6: Model memorandum i bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë dhe OSHC-së](#)
- [Shtojca 7: Thirrje publike për anëtarësim në Asamblenë e këshillit qendror/lokal Rinor](#)
- [Shtojca 8: Model i portofolios për aplikim për anëtarësi në asamble](#)
- [Shtojca 9: Shembull i rendit të ditës së mbledhjes konstitutive të asamblesë](#)

Meqë shtojcat e sipërpërmendura janë tashmë pjesë e Rregullores, ky doracak nuk i përmban ato, por me qëllim të ofrimit të mbështetjes shtesë për zbatimin e Rregullores për këshillat rinorë i ka të përfshira 6 shtojca shtesë:

- **Shtojca 1:** Portofoli i aplikuesit/OSHC-së
- **Shtojca 2:** Mbledhja konstitutive e këshillit qendror/lokal Rinor
- **Shtojca 3:** Kuptimi i aktit të themelimit të këshillit qendror/lokal Rinor – Shembull ilustrues
- **Shtojca 4:** Mbledhja e parë e këshillit qendror/lokal Rinor
- **Shtojca 5:** Kuptimi i rregullores së punës së Këshillit Qendror Rinor dhe këshillave lokalë rinorë
- **Shtojca 6:** Shembull i planit vjetor të punës dhe buxhetit të Këshillit Qendror Rinor dhe këshillave lokalë rinorë

Këto shtojca lehtësojnë zbatimin e rregullores dhe synojnë të mbështesin kapacitetet e anëtarëve të Këshillit Qendror Rinor dhe këshillave lokalë rinorë për t'i zbatuar më mirë dispozitat e Rregullores për këshillat rinorë. Këshillat janë të pavarur në organizimin e punës së tyre.

## SHTOJCA 1: Përmbledhje e përvojës së aplikuesit/OSHC-së

Gjatë aplikimit për anëtarësim në Këshillin Qendror Rinor ose këshillat lokalë rinorë, një nga dokumentet që kërkohet nga Agjencia për Zhvillimin e Rinisë/drejtoria komunale për rini është portofoli i përvojës (për modelin e portofolit, shih Shtojcën 8 të Rregullores për Këshillat Rinorë).

### Cili është qëllimi?

Ky portofol është mundësia juaj për të paraqitur punën dhe përvojat e dy (2) viteve e fundit, për ta dëshmuar përkushtimin, shkathhtësitë dhe ndikimin tuaj në mbështetjen e zhvillimit të rinisë, promovimin e aktivizmit rinor dhe mbrojtjen e të drejtave të të rinjve.

### Katër elementët kyç të një portofoli të mirëpërpiluar:

- 1. Relevanca:** Është e rëndësishme të përqendroheni në aktivitete që lidhen drejtpërdrejt me zhvillimin e rinisë, pjesëmarrjen dhe aktivizmin e të rinjve, si dhe me të drejtat e të rinjve.
- 2. Qartësia:** Është thelbësore që informacioni të paraqitet në formë të qartë, të strukturuar dhe të lehtë për t'u lexuar.
- 3. Dëshmitë:** Çdo informacion duhet të mbështetet me dëshmi të besueshme si foto, vegëza në internet dhe rekomandime/dëshmi nga palë të treta.
- 4. Ndikimi:** Rekomandohet të pasqyroni ndikimin pozitiv të të rinjtë dhe në komunitet që ka sjellë secili aktivitet i paraqitur.

### Kërkesat:

Për secilin aktivitet, projekt ose program të përfshirë në portofol, është e rëndësishme të siguroheni se keni trajtuar sa vijon:

- 1. Emërtimi i aktivitetit, projektit ose programit:**
  - Jini konkret dhe përdorni emërtimin zyrtar të aktivitetit/projektit/programit.
- 2. Datat e aktivitetit, projektit ose programit:**
  - Jepni datën e fillimit dhe të përfundimit (ose datat e përfaqësuara, nëse datat e sakta nuk janë të disponueshme).
- 3. Përshkrimi i objektivave dhe arritjeve të aktivitetit, projektit ose programit:**
  - **Objektivat:** Mbani parasysh pyetje të tilla si: "çfarë po përpiqeshit të arrinit" ose "çfarë problemesh po përpiqeshit të zgjidhni"?
  - **Arritjet:** Përqendrohuni te rezultatet dhe ndryshimet pozitive, duke përdorur për shembull shifra sa herë që është e mundur për ta forcuar argumentin, p.sh. numri i pjesëmarrësve të përfshirë, numri i ndryshimeve të realizuara ose përqindja e pjesëmarrjes etj.
- 4. Dëshmitë:**
  - **Fotografite:** Përfshini fotografi cilësore që ju shfaqin ju dhe pjesëmarrës tjerë gjatë aktivitetit.
  - **Uebfaqe/Rrjete sociale:** Jepni vegëza të faqeve të internetit, faqeve në rrjete sociale ose artikuj online.
  - **Dëshmi/rekomandime:** Kur është e mundur, përfshini citime nga pjesëmarrës ose partnerë që ilustrojnë ndikimin pozitiv të punës suaj.
  - **Certifikata/Çmime:** Nëse keni marrë ndonjë certifikatë ose çmim për punën tuaj, bashkëngjitni kopje të tyre.

### **Këshilla:**

- Përqendrohuni në aktivitetet ku keni pasur ndikimin më të madh dhe keni mësuar më së shumti. Mos përfshini gjithçka që keni bërë – cilësia ka përparësi kundrejt sasisë!
- Lexoni me kujdes misionin dhe objektivat e KQR-së/KLR-ve. Theksoni përvojat që janë të lidhura me punën e tyre.
- Kur i përshkruani arritjet, përdorni folje veprimi të sakta për ta paraqitur qartë atë çfarë keni bërë.
- Sa herë që është e mundur, përdorni shifra për ta ilustruar ndikimin e punës suaj.
- Kërkojini ndonjë mësuesi/je, mentori/je ose miku/eje që ta rishikojë portofolin tuaj dhe t'ju japë komente.

## SHTOJCA 2: Mbledhja konstituive e këshillit qendror/lokal Rinor

Mbledhja konstituive e këshillit qendror/lokal Rinor është mbledhja e parë ku Asambleja e KQR-së/KLR-ve mbledhet për ta themeluar Këshillin.

### Cili është kuorumi i Asamblesë së KQR/KLR?

Ndonëse numri i saktë i nevojshëm për kuorum varet nga numri i anëtarëve të asamblesë, kërkohet shumicë e thjeshtë, që do të thotë 50 % + 1.

### DITA E PARË E MBLEDHJES KONSTITUIVE

- ✓ Hapja e mbledhjes nga anëtari më i moshuar i asamblesë.
- ✓ Përcaktimi i rregullave.
- ✓ Vetënominimi për anëtarësim në Këshillin Qendror/Lokal Rinor. Ndonëse KQR-ja nuk themelohet përmes KLR-ve, anëtarët e KLR-ve kanë të drejtë të nominohen dhe të zgjidhen në KQR, ashtu si edhe anëtarët e KQR-së që mund të nominohen dhe të zgjidhen në KLR.
- ✓ Anëtarët e asamblesë marrin pjesë në seanca të ndryshme diskutimi për përmirësimin e sektorit të rinisë (përfundimet e nxjerra gjatë këtyre seancave mund të merren në konsideratë nga Këshilli Qendror Rinor/këshillat lokalë rinorë gjatë fazës së hartimit të planit vjetor). Anëtarët e vetënominuar për këshilla bëjnë fushatë për zgjedhjen e tyre gjatë diskutimeve.

Nuk ka **kufizim** për numrin e anëtarëve të asamblesë, si për Këshillin Qendror Rinor ashtu edhe për këshillat lokalë rinorë. Numri i anëtarëve të KQR-së është **21**, duke marrë parasysh dispozitat për **gjithëpërfshirje** dhe **përfaqësim** sipas të cilave të paktën 30 për qind e anëtarëve janë vajza dhe gra të reja, të paktën 20 për qind e anëtarëve u përkasin komuniteteve joshumicë dhe të paktën 10 për qind e anëtarëve janë persona me aftësi të kufizuara. KLR përbëhet nga një numër tek anëtarësh, **jo më shumë se 1/3** të numrit të anëtarëve të kuvendit të komunës përkatëse dhe **jo më pak se pesë anëtarë**, duke marrë në konsideratë dispozitat për gjithpërfshirje dhe përfaqësim sikundër në rastin e KQR-së.

### DITA E DYTË E MBLEDHJES KONSTITUIVE

- ✓ Modalitetet e votimit të fshehtë.
- ✓ Numërimi i votave dhe zgjedhja e anëtarëve të këshillit qendror/lokal Rinor.
- ✓ KQR/KLR i zgjedhur harton aktin e themelimit (shih Shtojcën 1 Rregullores për këshillat rinorë për modelin e aktit të themelimit, kurse për këshilla se si të hartohet akti i themelimit, shih Shtojcën 3 të këtij Doracaku). Paralelisht, anëtarët e Asamblesë marrin pjesë në seanca të strukturuar diskutimi mbi çështje kyçe të politikave dhe zhvillimit të rinisë si p.sh. punësimi i të rinjve, arsimit etj. (përfundimet e nxjerra gjatë këtyre seancave mund të merren parasysh nga KQR/KLR gjatë fazës së hartimit të planit vjetor).

- ✓ Votimi i Aktit të Themelimit të këshillit qendror/lokal Rinor nga Asambleja.
- ✓ Caktimi i datës së mbledhjes së radhës të këshillit qendror/lokal Rinor për zgjedhjen e kryesisë dhe hartimin e rregullores së punës, si dhe për nisjen e përgatitjeve për planin vjetor të punës.

*Për modelin e rendit të ditës së mbledhjes konstituive, shih Shtojcën 9 të Rregullores për Këshillat Rinorë. Shih po ashtu Shtojcën 3 të Rregullores për Këshillat Rinorë për modelin e procesverbalit të mbledhjes konstituive.*

Agjencia për Zhvillimin e Rinisë, në bashkëpunim me rrjetin e OSHC-ve, përkatësisht drejtoria komunale për rini, në bashkëpunim me KQR-në, i dërgon tre dokumentet e mëposhtme ministrit të Sportit dhe Rinisë ose kryetarit të komunës për njohjen e KQR-së ose KLR-ve.

- ✓ Procesverbalin e mbledhjes konstituive të këshillit qendror/lokal Rinor
- ✓ Listën e anëtarëve të zgjedhur të këshillit qendror/lokal Rinor
- ✓ Listën e rezultateve të votimit/renditjen e kandidatëve sipas numrit të votave.

Një shembull i njoftimit për njohje ndodhet në Shtojcën 4 të Rregullores për këshillat rinorë.

## SHTOJCA 3: Kuptimi i aktit të themelimit të këshillave rinore qendrore/lokale - NJË SHEMBULL

Dokumenti i parë i këshillave rinore qendrore/lokale është akti i themelimit, që hartohet dhe miratohet nga kuvendi i këshillave gjatë mbledhjes konstituive (për modelin e aktit të themelimit, referojuni Shtojcës 1 të Rregullores për këshillat rinore).

Neni	Shpjegimi
<p data-bbox="432 562 537 629"><b>Neni 1</b> <b>Qëllimi</b></p> <ol data-bbox="217 685 756 1608" style="list-style-type: none"><li>1. Ky akt themelimi përcakton rregullat e organizimit, funksionimit dhe aktivitetit, si dhe është dokumenti kryesor i këshillit qendror/lokal rinor.</li><li>2. Dispozitat e këtij akti themelimi zbatohen nga këshilli qendror/lokal rinor dhe të gjithë personat e angazhuar në dhe mbi aktivitetin e këshillit qendror/lokal rinor.</li><li>3. Këshilli qendror/lokal rinor ushtron aktivitetin e tij në pajtim me Ligjin Nr. 08/L-264 për Rininë, si dhe Rregulloren (MSR) nr. 09/2024 për Procedurat për krijimin, funksionimin dhe punën e Këshillave Rinorë.</li><li>4. Të gjithë dokumentet zyrtare të këshillit qendror/lokal rinor duhet të jenë në përputhje me dispozitat e këtij akti themelimi.</li></ol>	<p data-bbox="831 685 1347 891"><b>Kuptimi:</b> Ky nen përcakton rregullat, organizimin, funksionimin dhe aktivitetet e këshillit qendror/lokal rinor. Ky nen e përcakton këtë akt si dokumentin kryesor udhëzues.</p> <p data-bbox="831 943 1347 1189"><b>Rëndësia:</b> Ky vë themelet për ekzistencën dhe funksionimin e këshillit, duke siguruar që të gjitha aktivitetet të jenë në pajtim me kërkesat ligjore dhe me parimet e tij thelbësore.</p> <p data-bbox="831 1240 1347 1487"><b>Si të shkruhet:</b> Të jetë i qartë e konciz. Të theksohet që ky akt përcakton kornizën operative të këshillit. T'i referohet ligjeve dhe rregulloreve përkatëse që rregullojnë aktivitetet e këshillit.</p>
<p data-bbox="336 1767 639 1839"><b>Neni 2</b> <b>Parimi jo-fitimprurës</b></p> <ol data-bbox="217 1883 724 2047" style="list-style-type: none"><li>1. Këshilli qendror/lokal rinor nuk shpërndan të ardhura ose fitime për asnjë person.</li><li>2. Asetet, të ardhurat dhe fitimet e</li></ol>	<p data-bbox="831 1861 1347 2063"><b>Kuptimi:</b> Siguron që këshilli qendror/lokal rinor të veprojë në bazë jofitimprurëse, duke ndaluar shpërndarjen e të ardhurave ose fitimeve tek individët.</p>



këshillit qendror/lokal rinor përdoren për të mbështetur qëllimet e tij jofitimprurëse.

3. Pasuritë, të ardhurat dhe fitimet e këshillit qendror/lokal rinor nuk mund të përdoren për dobi të ndonjë themeluesi, anëtari, punonjësi apo donatori të

**Rëndësia:** Ruan integritetin dhe besimin publik në këshill duke siguruar që burimet e tij përdoren vetëm për qëllimet e synuara jo-fitimprurëse.

**Si të shkruhet:** Theksohet se pasuritë dhe të ardhurat e këshillit janë të dedikuara për të mbështetur objektivat e tij jofitimprurëse. Deklarohet shprehimisht se asnjë përfitim nuk duhet t'u shtohet/akumulohet themeluesve, anëtarëve ose donatorëve.

### **Neni 3** **Konflikti i interesit dhe detyrimi fiduciar**

1. Asnjë anëtar i këshillit qendror/lokal rinor nuk lejohet të marrë pjesë në diskutim ose vendimmarrje për çështje kur ka interes të drejtpërdrejtë ose të tërthortë privat, personal ose financiar, i cili ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në ligjshmërinë, transparencën, objektivitetin dhe paanshmërinë e tij/saj në ushtrimin e funksionit.
2. Çdo transaksion midis organizatave anëtare të këshillit qendror/lokal rinor dhe anëtarëve individualë bëhet sipas vlerës së tregut ose sipas kushteve më të favorshme.
3. Të gjithë anëtarët e këshillit qendror/lokal rinor janë të detyruar të tregojnë besnikëri ndaj Këshillit Qendror/Lokal, të mbrojnë konfidencialitetin e informacionit jo-publik dhe interesat e Këshillit Qendror/Lokal, si dhe të ushtrojnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre me mirëbesim dhe kujdes.

**Kuptimi:** Adreson konfliktet e mundshme të interesit dhe kërkon besnikëri nga anëtarët e këshillit.

**Rëndësia:** Garanton transparencë, objektivitet dhe paanshmëri në vendimmarrje, duke mbrojtur interesat e këshillit.

**Si të shkruhet:** Të ndalohen anëtarët të marrin pjesë në diskutime ose vendime ku ata kanë një interes personal ose financiar. Të kërkohej që anëtarët të veprojnë me mirëbesim, të mbrojnë informacionin konfidencial dhe të bëjnë prioritet interesat e këshillit

#### **Neni 4** **Transaksionet financiare të këshillit qendror/lokal rinor**

1. Të gjitha transaksionet financiare të aktiviteteve të planit vjetor të këshillit qendror/lokal rinor kryhen nga Agjencia për Zhvillimin e Rinisë/Drejtoria Komunale e Rinisë dhe/ose nga donatorë vendorë dhe ndërkombëtarë.
2. Në rastet kur këshilli qendror/lokal rinor duhet të marrë mbështetje financiare nga donatorë vendorë dhe/ose ndërkombëtarë dhe është e pamundur ta realizojë mbështetjen si grup joformal, një OSHC anëtare e këshillit qendror/lokal mund të zgjidhet për të kryer të gjitha transaksionet financiare në emër të këshillit qendror/lokal rinor.
3. OSHC-ja e zgjedhur si sekretariat nga anëtarët e Këshillit përmes votimit të hapur duhet të përcaktohet në rregulloren e punës së këshillit qendror/lokal rinor.
4. Të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e këshillit qendror/lokal rinor kryhen nëpërmjet institucioneve financiare të licencuara nga Banka Qendrore në llogaritë bankare të hapura në emër të OSHC-së përfaqësuese përveç rasteve që lejohen nga legjislacioni në fuqi.

**Kuptimi:** Përshkruan procedurat për transaksionet financiare, duke specifikuar se ato duhet të kryhen nga AZHVR/Drejtoria Komunale e Rinisë dhe/ose nga donatorët.

**Rëndësia:** Të sigurojë llogaridhënien dhe menaxhimin e duhur të financave të këshillit.

**Si të shkruhet:** Të përshkruhet hollësisht procesin e transaksioneve financiare, duke theksuar rolin e AZHR/Drejtorisë Komunale për Rini ose organeve të tjera të caktuara. Të specifikohen kushtet sipas të cilave OSHC-ja mund të marrë përsipër transaksionet financiare në emër të këshillit. Të urdhërohet që të gjitha transaksionet të kryhen nëpërmjet institucioneve financiare të licencuara.

#### **Neni 5** **Ndalimi i mbledhjes së fondeve, fushatave dhe mbështetjes së kandidatëve dhe partive politike**

Këshilli qendror/lokal rinor nuk mund të angazhohet në mbledhje fondesh

**Kuptimi:** I ndalon këshillit qendror/lokal rinor të angazhohet në

ose fushata për të mbështetur partitë politike ose kandidatët për poste politike, as nuk mund të propozojë e as regjistrojë kandidatë për poste politike.

aktivitete politike.

**Rëndësia:** Ruan neutralitetin e këshillit dhe parandalon përdorimin e tij për përfitime politike.

**Si të shkruhet:** Të thuhet qartë se këshilli nuk mund të marrë pjesë në mbledhje fondesh ose fushata për të mbështetur partitë apo kandidatët politikë. T'i ndalohet këshillit të propozojë apo regjistrojë kandidatë për poste politike.

### **Neni 6 Rregullorja e Punës**

Këshilli qendror/lokal rinor, në përputhje me këtë Akt themelimi dhe legjislacionin përkatës në fuqi, miraton rregulloren e punës për metodën e vendimmarrjes dhe aktivitetin e vet.

**Kuptimi:** I jep mandat këshillit qendror/lokal rinor që të miratojë rregulloret e punës.

**Rëndësia:** Ofron një kornizë për vendimmarrje dhe aktivitete të këshillit.

**Si të shkruhet:** Të specifikohet që këshilli duhet të miratojë rregulloret e punës në përputhje me Aktin e themelimit dhe legjislacionin përkatës.

### **Neni 7 Shpërbërja**

1. Në rastet e mosfunksionimit të këshillit qendror/lokal, Agjencia për Zhvillimin e Rinisë/Drejtoria Komunale duhet ta dokumentojë mosfunksionimin përmes një raporti dhe t'ia paraqesë Kuvendit të këshillit qendror/lokal me rekomandimin për shpërbërje.
2. Këshilli qendror/lokal rinor mund të shpërbëhet me vendim të dy të tretave (2/3) të anëtarëve të Kuvendit.

**Kuptimi:** Specifikon kushtet dhe procedurat për shpërbërjen e këshillit qendror/lokal rinor.

**Rëndësia:** Ofron një mekanizëm për adresimin e situatave kur këshilli nuk është më funksional.

**Si të shkruhet:** Përshkruan procesin për dokumentimin e mosfunksionimit dhe paraqitjen e rekomandimit për shpërbërje. Specifikohen kërkesat e votimit për shpërbërjen e këshillit.

## Neni 8 Hyrja në fuqi

1. Ky Akt i themelimit mund të ndryshohet me dy të tretat (2/3) e votave të anëtarëve të kuvendit të këshillit qendror/lokal rinor.
2. Ky Akt themelimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga asambleja e këshillit qendror/lokal rinor.

**Kuptimi:** Përcakton se si mund të ndryshohet Akti i themelimit dhe kur hyn në fuqi.

**Rëndësia:** Ofron qartësi mbi statusin ligjor dhe procesin e modifikimit të dokumentit.

**Si të shkruhet:** Theksohen kriteret e votimit për ndryshimin e Aktit të themelimit. Specifikohet që Akti hyn në fuqi pas miratimit nga kuvendi i këshillit qendror/lokal rinor.

## SHTOJCA 4: Takimi i parë i këshillave rinorë qendrorë/lokalë

Pas zgjedhjeve, KRQ/KRL vendos për datën (brenda 15 ditëve nga miratimi i Aktit të themelimit) të takimit të parë me qëllim që të:

1. Zgjidhet kryesia
2. Hartohet plani i punës
3. Vendoset për procesin e hartimit të planit vjetor të aktiviteteve dhe buxhetit

Rekomandohet që mbledhja e parë të mbahet me të gjithë anëtarët e KRQ/KRL-së të pranishëm në mbledhje!

### Dita e parë e këshillave rinorë qendrorë/lokalë

- ✓ Fjala hyrëse nga anëtari më i vjetër i këshillit qendror/lokal rinor
- ✓ Vetë-nominimi i anëtarëve të këshillit qendror/lokal rinor për Kryesi.
- ✓ Votimi zhvillohet me fletëvotim të hapur (materialet zgjedhore sigurohen nga Agjencia për Zhvillimin e Rinisë).
- ✓ Zgjedhja e kryesisë.

#### Kryesia e Këshillit Qendror Rinor:

- Kryetari/ja (kandidati/ja më e votuar)
- Katër (4) nën-kryetarë (bazuar në renditje vote)
- Sekretar (bazuar në renditje vote)

#### Kryesia e këshillit lokal rinor:

- Kryetari/ja (kandidati/ja më e votuar)
- Dy (2) nën-kryetarë (bazuar në renditje vote)
- Sekretar (bazuar në renditje vote)

**Këshillë:** Rekomandohet të keni listë pritjeje bazuar në renditjen e votave. Kjo ka rëndësi tek rastet kur një anëtar i Kryesisë vendos vullnetarisht të largohet nga pozita/ose shkarkohet nga Kuvendi para përfundimit të mandatit trevjeçar. Zëvendësimi bëhet në bazë të renditjes më të lartë në listën e pritjes.

### Dita e dytë e takimit të parë të këshillave qendrorë/lokalë rinor

- ✓ Kryesia e zgjedhur harton Planin e Punës së KQR-së/KLR-së (për modelin e planit të punës, ju lutemi referojuni Shtojcës 2 të Rregullores për këshillat rinorë; për këshilla se si të hartohet plani i punës, ju lutemi referojuni Shtojcës 5 të këtij Doracaku).
- ✓ Plani i punës votohet dhe miratohet nga KQR/KLR-ja.
- ✓ KQR/KLR vendos për procesin e hartimit të Planit vjetor të aktiviteteve dhe buxhetit (për rekomandime se si të hartoni planin vjetor të aktiviteteve dhe buxhetin, ju lutemi referojuni Shtojcës 6 të këtij Doracaku).

## SHTOJCA 5: Kuptimi i rregullores së punës së Këshillit Qendror Rinor dhe këshillave lokalë rinore

Neni	Shpjegimi
<p data-bbox="437 416 539 483"><b>Neni 1 Qëllimi</b></p> <p data-bbox="213 539 759 741">Kjo rregullore pune rregullon mënyrën e vendimmarrjes dhe aktivitetin e këshillit qendror/lokal rinor të Komunës së _____ (emri i komunës).</p>	<p data-bbox="831 539 1345 701"><b>Kuptimi:</b> Përcakton se kjo rregullore rregullon proceset e vendimmarrjes dhe aktivitetet e këshillit qendror/lokal rinor.</p> <p data-bbox="831 752 1366 824"><b>Rëndësia:</b> Vendos kornizën për veprimtarinë dhe vendimet e këshillit.</p> <p data-bbox="831 880 1369 1041"><b>Si të shkruhet:</b> Të thuhet qartë se rregullorja përshkruan procedurat për vendimmarrje dhe aktivitetet e përgjithshme të këshillit.</p>
<p data-bbox="217 1167 759 1267"><b>Neni 2 Fushëveprimi i këshillit qendror/lokal rinor</b></p> <p data-bbox="217 1319 743 1435">1. këshilli qendror/lokal rinor funksionon brenda fushëveprimit si në vijim:</p> <p data-bbox="261 1487 746 1821"><i>(shkruaj fushëveprimin dhe qëllimin e themelimit të këshillit qendror/lokal rinor, që duhet të përfshijë pikat nga neni 3/neni 19 i Rregullores (MSR) Nr. 09/2024 mbi Procedurat për themelimin, funksionimin dhe punën e këshillave rinorë.).</i></p>	<p data-bbox="831 1319 1257 1435"><b>Kuptimi:</b> Përcakton fushat e përgjegjësisë dhe objektivat e këshillit qendror/lokal rinor.</p> <p data-bbox="831 1487 1345 1603"><b>Rëndësia:</b> Cakton kufijtë e punës së këshillit dhe siguron që ai të përqendrohet në qëllimet e synuara.</p> <p data-bbox="831 1655 1326 1850"><b>Si të shkruhet:</b> Renditni fushat specifike të fokusit dhe objektivat, duke iu referuar neni 3/neni 19 të Rregullores (MSR) Nr. 09/2024 për udhëzime të hollësishme.</p>

### Neni 3 Strukturat udhëheqëse

1. Strukturat drejtuese të këshillit qendror/lokal rinor janë:
  - 1.1. Kuvendi i këshillit qendror/lokal rinor;
  - 1.2. Këshilli Rinor Qendror/Lokal;
  - 1.3. Kryesia e këshillit qendror/lokal rinor.

**Kuptimi:** Identifikon organet kryesore udhëheqëse brenda këshillit qendror/lokal rinor.

**Rëndësia:** Sqaron strukturën organizative dhe linjat e kompetencave.

**Si të shkruhet:** Renditen tri strukturat udhëheqëse: Kuvendin, vetë këshillin qendror/lokal rinor dhe Kryesinë.

### Neni 4 Kuvendi i këshillit qendror/lokal rinor

1. Kuvendi është organi themelues i këshillit qendror/lokal rinor, i cili përbëhet nga përfaqësues të organizatave rinore, organizatave për të rinjtë, parlamenteve studentore, këshillave studentore dhe forumeve rinore të partive politike.
2. Kuvendi është përgjegjës për themelimin e këshillit qendror/lokal rinor, për votimin e aktit të themelimit të këshillit qendror/lokal rinor dhe, në rastet e kërkesës nga Kryesia e këshillit qendror/lokal rinor, për votimin e vendimeve të Kryesisë.
3. Kuvendi është përgjegjës për të ndërhyrë në rastet e mosfunksionimit sipas nenit 12/nenit 28 të Rregullores (MSR) Nr. 09/2024 mbi Procedurat për Themelimin, Funkcionimin dhe Punën e Këshillave Rinorë.

**Kuptimi:** Përcakton përbërjen dhe përgjegjësitë e Kuvendit.

**Rëndësia:** Themelon Kuvendin si organin themelues dhe përshkruan funksionet e tij kryesore.

**Si të shkruhet:** Përshkruhet Kuvendi që përbëhet nga përfaqësues të organizatave të ndryshme rinore dhe organe studentore (për listën e plotë, ju lutemi referojuni kapitullit 2 dhe kapitullit 3). Renditni përgjegjësitë e tij: themelimin e këshillit, votimin për dokumentet kryesore dhe ndërhyrjen në rastet e mosfunksionimit. Referojuni nenit 12/nenit 28 të Rregullores (MSR) nr. 09/2024 për mosfunksionim.



## Neni 5 Këshilli qendror/lokal rinor

1. Këshilli qendror/lokal rinor është grup joformal këshillimi, avokimi dhe monitorimi për çështjet rinore i cili, në përputhje me përkufizimin e dhënë në Ligjin Nr. 08/L-254 për Rininë, ka formën e organizimit si grup joformal dhe themelohet me mandat tre (3) vjeçar.
2. Numri i anëtarëve të këshillit qendror/lokal është \_\_\_\_.
3. Këshilli qendror/lokal duhet të sigurojë përfaqësim të barabartë dhe gjithëpërfshirës, ku të paktën 30 përqind e anëtarëve janë gra dhe të paktën 20 përqind i përkasin të rinjve nga grupet e komunitetit jo-shumicë dhe 10 përqind nga personat me aftësi të kufizuara.
4. Ndonëse këshilli qendror sipas përkufizimit nuk buron nga këshillat lokalë, anëtarët e këshillave lokalë kanë të drejtë të nominohen e të zgjidhen në Këshillin Qendror, si dhe anasjelltas.

**Kuptimi:** Përkufizon këshillin qendror/lokal rinor si organ joformal këshillues, avokues dhe monitorues.

**Rëndësia:** Sqaron rolin e këshillit dhe mandatin e tij si grup joformal.

**Si të shkruhet:** Theksohet se këshilli është organ këshillimor joformal me një mandat tre-vjeçar. Specifikohet që duhet të sigurojë përfaqësim të barabartë, me të paktën 30 përqind anëtare femra, 20 përqind nga grupet jo-shumicë dhe 10 përqind për personat me aftësi të kufizuara për këshillin rinor qendror. Për këshillin rinor lokal, specifikohet që standardet e përfaqësimit gjithëpërfshirës për komunitetet jo-shumicë dhe personat me aftësi të kufizuara bazohen në të dhënat demografike përkatëse. Shpjegohet marrëdhënia midis anëtarëve të këshillit qendror dhe atij lokal.

## Neni 6 Kryesia e këshillit qendror/lokal rinor

1. Kryesia e këshillit qendror/lokal rinor është organi më i lartë drejtues dhe përfaqësuesi i autorizuar i këshillit qendror/lokal.
2. Kryesia e këshillit qendror/lokal rinor përbëhet nga kryetari dhe nënkryetarët, dhe mbështetet nga

**Kuptimi:** Përkufizon Kryesinë si organin më të lartë qeverisës.

**Rëndësia:** Përcakton rolin udhëheqës të Kryesisë dhe autoritetin e saj.

- një (1) sekretar pa të drejtë vote.
3. Kryesia e këshillit qendror/lokal rinor zgjidhet nga anëtarët e këshillit qendror/lokal rinor me votë të hapur.
  4. Kryesia mund të shkarkohet nga Kuvendi me 50+1 përqind të votave të anëtarëve të saj, nëse ka kryer shkelje të rënda të detyrave të punës.

**Si të shkruhet:** Theksohet që Presidenca është organi më i lartë qeverisës dhe përfaqësuese e autorizuar. Përshkruhet përbërja e sa (Kryetari/ja, nënkryetarët dhe një sekretar pa të drejtë vote). Shpjegohet që Kryesia zgjidhet nga anëtarët e këshillit dhe mund të shkarkohet nga Kuvendi për shkelje të rënda.

### **Neni 7 Kryetari/ja**

1. Kryetari/ja i këshillit qendror/lokal rinor është përgjegjës për këto veprime:
  - 1.1. Organizon mbledhjet e këshillit qendror/lokal dhe i kryeson ato;
  - 1.2. Siguron hartimin e planit vjetor të veprimit të këshillit qendror/lokal rinor;
  - 1.3. Nënshkruan aktet e miratuara nga këshilli qendror/lokal rinor dhe siguron që ato të zbatohen;
  - 1.4. Siguron dhe drejton punën dhe funksionimin e këshillit qendror/lokal rinor në përputhje me aktin e themelimit;
  - 1.5. Ndërmerr masa për zbatimin e planit të veprimit dhe përfundimeve nga mbledhjet e këshillit qendror/lokal rinor;
  - 1.6. Përfaqëson Këshillin Qendror Rinor para institucioneve publike qendrore/përfaqëson këshillin rinor lokal para institucioneve publike lokale dhe në takimet e organizuara nga Këshilli Qendror Rinor.

**Kuptimi:** Përcakton përgjegjësitë e kryetarit/es.

**Rëndësia:** Përcakton rolin udhëheqës të kryetarit/es dhe detyrat e tij/saj kryesore.

**Si të shkruhet:** Renditen përgjegjësitë e kryetarit/es: organizimi dhe kryesimi i mbledhjeve, hartimi i planit të veprimit, nënshkrimi i akteve, sigurimi i respektimit të aktit të themelimit, zbatimi i planit të veprimit dhe përfaqësimi i këshillit së jashtmi.

## **Neni 8** **Nënkryetarët e këshillit qendror/lokal rinor**

1. Këshilli Qendror Rinor ka katër (4) nënkryetarë / këshilli lokal rinor ka dy (2) nënkryetarë.
2. Nënkryetarët e këshillit qendror/lokal rinor janë përgjegjës për:
  - 2.1. Zëvendësojnë kryetarin/en në rast mungese;
  - 2.2. Mbështesin kryetarin/en në zbatimin e detyrave dhe përgjegjësive të renditura në nenin 2 të kësaj Rregulloreje;
  - 2.3. Udhëheqin komitetet, menaxhojnë anëtarët e komiteteve dhe sigurojnë zbatimin e detyrave dhe përgjegjësive të komitetit.

**Kuptimi:** Përkufizon përgjegjësitë e nënkryetarëve.

**Rëndësia:** Sqaron rolin mbështetës të nënkryetarëve dhe detyrat e tyre specifike.

**Si të shkruhet:** Specifikohet numri i nënkryetarëve për Këshillin Qendror dhe ata lokal. Renditen përgjegjësitë e tyre: zëvendësimi i kryetarit/es në mungesë të tij/saj, mbështetja e kryetarit/es, drejtimi i komiteteve dhe menaxhimi i punës së komiteteve.

## **Neni 9** **Sekretari/ja**

1. Sekretari/ja i këshillit qendror/lokal rinor është përgjegjës për këto veprime:
  - 1.1. Siguron përparimin administrativ të këshillit qendror/lokal rinor;
  - 1.2. Planifikon dhe mbanë shënime për mbledhjet;
  - 1.3. Menaxhon komunikimin dhe dokumentet;
  - 1.4. Siguron që Këshilli Qendror të ndjekë rregullat procedurale.

**Kuptimi:** Përcakton përgjegjësitë e sekretarit/es.

**Rëndësia:** Përcakton rolin mbështetës administrativ dhe procedural të sekretarit/es.

**Si të shkruhet:** Renditen përgjegjësitë e sekretarit/es: sigurimi i progresit administrativ, planifikimi dhe mbajtja e shënimeve të mbledhjeve, menaxhimi i komunikimit dhe dokumenteve, regjistrimi dhe arkivimi i dokumenteve për të siguruar memorien institucionale të këshillit qendror/lokal rinor dhe sigurimi i pajtueshmërisë procedurale.

## **Neni 10** **Anëtarët e këshillit qendror/lokal rinor**

1. Anëtarët e këshillit qendror/lokal rinor janë përgjegjës për veprimet në vijim:
  - 1.1. Pjesëmarrje në mbledhjet e këshillit qendror/lokal rinor;
  - 1.2. Propozojnë tema dhe aktivitete për diskutim;
  - 1.3. Pjesëmarrje në vendimmarrje dhe marrje të nismave për zbatimin e planit të punës së këshillit qendror/lokal rinor;
  - 1.4. Kontribut në përpilimin e dokumenteve të këshillit qendror/lokal rinor;
  - 1.5. Pjesëmarrje aktive në punën e komiteteve të këshillit qendror/lokal rinor.

**Kuptimi:** Përkufizon përgjegjësitë e anëtarëve të Këshillit.

**Rëndësia:** Sqaron nivelin e pritur të pjesëmarrjes dhe kontributit nga anëtarët.

**Si të shkruhet:** Renditen përgjegjësitë e anëtarëve: pjesëmarrja në mbledhje, propozimi i temave për diskutim dhe aktivitete, pjesëmarrja në vendimmarrje, kontributi në dokumente dhe pjesëmarrja aktive në komitete.

## **Neni 11** **Komitetet**

1. Këshilli qendror/lokal rinor mund të organizohet në komitete për të mbuluar të gjitha fushat me interes për të rinjtë.
2. Këshilli Qendror Rinor ka katër (4) komitete / këshilli lokal rinor ka dy (2) komitete.
3. Komitetet e këshillit qendror/lokal rinor janë:

*Shembull për Këshillin Qendror:*

- 3.1. Komiteti për Politika e Avokim (fokusohet në këshillimin e institucioneve publike, identifikimin e nevojave të të rinjve dhe avokimin për çështjet e të rinjve. Siguron monitorimin e zbatimit të politikave);

**Kuptimi:** Përshkruan organizimin dhe funksionin e komiteteve brenda këshillit.

**Rëndësia:** I lejon këshillit të përqendrohet në fusha specifike me interes dhe ekspertizë.

**Si të shkruhet:** Theksohet që këshilli mund të organizohet në komitete që mbulojnë fusha që lidhen me të rinjtë. Specifikohet numri i komiteteve për Këshillin Qendror dhe ata lokal. Jepen shembuj të temave të komiteteve (Politika dhe Avokim, Mbështetje për këshilla lokale, partneritete, ngjarje dhe konferenca). Theksohet që komitetet drejtohen nga nënkryetarët.

3.2. Komiteti për mbështetje të këshillave lokalë (fokusohet në mbështetjen e këshillave lokalë rinorë në aktivitetet dhe funksionimin e tyre); Ky komitet është i detyrueshëm pasi bazuar në nenin 31 të Rregullores, KQR vepron si mentor për KLR-të;

3.3. Komiteti për partneritet dhe bashkëpunim (përgjegjës për krijimin e partneriteteve me institucione, OSHC dhe organizata ndërkombëtare);

3.4. Komiteti për ngjarje dhe konferenca (organizimi i ngjarjeve, duke përfshirë konferencën vjetore të të rinjve dhe takimet publike).

*Shembull për këshillin lokal:*

3.1. Komiteti për Politika e Avokim (fokusohet në këshillimin e institucioneve publike, identifikimin e nevojave të të rinjve dhe avokimin për çështjet e të rinjve. Siguron monitorimin e zbatimit të politikave);

3.2. Komiteti për ngjarje dhe partneritete (përqendrohet në bashkëpunimin me Këshillin Qendror, organizimin e ngjarjeve dhe krijimin e partneriteteve me institucione, OSHC dhe organizata ndërkombëtare).

4. Komitetet e këshillit qendror/lokal rinor mund të bazohen në strukturën e fushave që rrjedhin nga Strategjia për rininë.
5. Komitetet e këshillit qendror/lokal rinor drejtohen nga nënkryetarët, të cilët sigurojnë mbajtjen e evidencës së punës dhe përfaqësojnë komitetin në

Përmendet që komitetet mund të bazohen në Strategjinë për Rininë.

takimet brenda dhe jashtë këshillit qendror/lokal rinor, si dhe para institucioneve publike qendrore/lokale.

## **Neni 12** **Kushtet për anëtarësim në këshillin qendror/lokal rinor**

1. Të gjithë anëtarët e këshillit qendror/lokal rinor duhet të:
  - 1.1. Pranojnë aktin e themelimit;
  - 1.2. Angazhohen për përmbushjen e qëllimeve të Këshillit;
  - 1.3. (nëse ka kushte të tjera specifike, shtohen këtu).
2. Anëtarësia në këshillin qendror/lokal rinor është e hapur për çdo person që plotëson kushtet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, mendimet politike ose të tjera, origjina etnike ose shoqërore, lidhja me ndonjë komunitet, prona, statusi ekonomik, shoqëror, orientimi seksual, lindja, aftësia e kufizuar apo cilido status tjetër personal.
3. Këshilli qendror/lokal rinor emëron anëtarë të rinj në rastet kur:
  - 3.1. Anëtari/ja dorëhiqet;
  - 3.2. Anëtari/ja kalon moshën rinore.
  - 3.3. Kryesia e këshillit qendror/lokal propozon largimin e cilitdo anëtari për shkak të shkeljes së rregullore së punës, për shembull:
    - 3.3.1. Mungesa e vazhdueshme e pajustificuar nga aktivitetet dhe mbledhjet e Këshillit Qendror/Lokal;
    - 3.3.2. Shkelje e kodit të sjelljes dhe etikës;
    - 3.3.3. Dështim në shmangie të konfliktit të interesit dhe/ose shkelje e parimit të besnikërisë ndaj

**Kuptimi:** Përcakton kriteret për t'u bërë dhe për të qëndruar si anëtar i këshillit.

**Rëndësia:** Siguron që anëtarët të jenë të përkushtuar ndaj qëllimeve të këshillit dhe i përmbahen rregulloreve të tij.

**Si të shkruhet:** Renditen kushtet e anëtarësimit: pranimi i Aktit të themelimit, angazhimi për qëllimet e këshillit dhe kushtet tjera specifike. Theksohet që anëtarësimi është i hapur për të gjithë individët e kualifikuar, pavarësisht prapavijës së tyre. Përshkruhen arsyet e emërimit të anëtarëve të rinj (dorëheqja, moshë, shkeljet). Specifikohet procedura e shkarkimit (2/3 e votave). Shpjegohet përzgjedhja e anëtarëve të rinj nga listat rezervë dhe kohëzgjatja e mandatit të tyre.

- ndaj Këshillit Qendror/Lokal.
- Anëtari/ja shkarkohet me dy të tretat (2/3) e votave të anëtarëve të këshillit qendror/lokal.
  - Anëtarët e rinj zgjidhen sipas renditjes në listën e anëtarëve rezervë.
  - Mandati i anëtarit të ri zgjatë vetëm deri në fund të mandatit të këshillit qendror/lokal.

### **Neni 13** **Pjesëmarrja në aktivitetet e këshillit qendror/lokal rinor**

- Të gjithë anëtarët e këshillit qendror/lokal rinor duhet të marrin pjesë rregullisht në aktivitetet e këshillit qendror/lokal rinor.
- Në rast mungese, anëtari duhet ta informojë me shkrim Kryesinë e Këshillit për arsyen e mospjesëmarrjes.
- Në rastet e mospjesëmarrjes së pajustificuar në aktivitetet dhe mbledhjet e këshillit Qendror/lokal rinor për më shumë se tri (3) herë radhazi, Kryesia ka të drejtë të kërkojë shkarkimin e anëtarit nga këshilli qendror/lokal rinor.

**Kuptimi:** Theksohet rëndësia e pjesëmarrjes së rregullt të anëtarëve.

**Rëndësia:** Siguron që këshilli të ketë anëtarë aktivë dhe të angazhuar.

**Si të shkruhet:** Theksohet që anëtarët duhet të marrin pjesë rregullisht. Kërkohet nga anëtarët të njoftojnë Kryesinë për mungesat. I jepet Kryesisë e drejta për të kërkuar shkarkim për mungesa të pajustificuara.

### **Neni 14** **Mbledhjet e përgjithshme të këshillit qendror/lokal rinor**

- Këshilli qendror/lokal rinor takohet të paktën dy herë në vit për të diskutuar procesin e zbatimit të planit të punës.
- Këshilli qendror/lokal rinor përfaqëson zërin e të rinjve në

**Kuptimi:** Përcakton shpeshtësinë minimale për mbledhjet e përgjithshme.

**Rëndësia:** Sigurohet që këshilli të takohet rregullisht për të diskutuar



mbledhjet e Komisionit për Rininë/Këshillit Rinor Qendror.

**Si të shkruhet:** Theksohet që këshilli duhet të mbledhet të paktën dy herë në vit ose katër herë në vit, kur ka të bëjë me KRQ-në. Vini re se këshilli përfaqëson zërin e të rinjve në takimet përkatëse.

### **Neni 15 Procesverbali i mbledhjes**

1. Në fund të çdo mbledhjeje të këshillit qendror/lokal rinor, Sekretari harton procesverbalin e mbledhjes, i cili ndahet me anëtarët e këshillit qendror/lokal rinor.
2. Në fillim të çdo mbledhjeje të këshillit qendror/lokal rinor, anëtarët miratojnë procesverbalin e mbledhjes paraprake.

**Kuptimi:** Përcaktohet procesi për mbajtjen shënim dhe miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve.

**Rëndësia:** Sigurohet mbajtja e saktë e shënimeve si dhe llogaridhënia.

**Si të shkruhet:** Kërkohej që sekretari të përpilojë procesverbalet pas çdo mbledhjeje dhe t'ua ndajë ato anëtarëve. Theksohet që anëtarët duhet të miratojnë procesverbalin në fillim të mbledhjes vijuese. Procesverbalet duhet të arkivohen mirëfilli dhe të jenë të qasshme për të gjithë anëtarët e këshillit qendror/lokal rinor.

### **Neni 16 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

1. Mosmarrëveshjet midis anëtarëve dhe organeve të zgjedhura nga Kuvendi zgjidhen në mënyrë miqësore dhe në pajtim me Aktin e themelimit dhe rregullat e brendshme të këshillit qendror/lokal rinor.

**Kuptimi:** Përshkruhet procesi për zgjidhjen e konflikteve brenda këshillit.

**Rëndësia:** Ofron një mekanizëm për zgjidhjen miqësore të mosmarrëveshjeve.

**Si të shkruhet:** Theksohet që mosmarrëveshjet duhet të zgjidhen miqësisht në përputhje me Aktin e themelimit dhe rregullat e brendshme.

### **Neni 17 Raportimi**

1. Këshilli qendror/lokal detyrohet të paraqesë raportin vjetor

**Kuptimi:** Obligohet dorëzimi i raporteve vjetore në Agjencinë/Drejtorinë

përshkrues dhe atë financiar mbi zbatimin e aktiviteteve një herë në vit para Agjencisë/Drejtorisë Komunale të Rinisë.

2. Raporti vjetor përshkrues i dërgohet Kuvendit të këshillit qendror/lokal për njoftim.
3. Raporti për vitin paraprak duhet të paraqitet deri më pesëmbëdhjetë (15) shkurt të vitit vijues.

Komunale të Rinisë.

**Rëndësia:** Të sigurohet llogaridhënia dhe transparenca e aktiviteteve të Këshillit.

**Si të shkruhet:** Obligohet këshilli të paraqesë raporte vjetore përshkruese dhe financiare. Theksohet që raporti përshkrues duhet t'i dërgohet Kuvendit për njoftim. Specifikohet afati i fundit për dorëzimin e raportit (15 shkurt).

### **Neni 18 Ndryshim/plotësimet e Rregullores së Punës**

Ndryshim/plotësimet në këtë Rregullore bëhen në të njëjtën mënyrë dhe procedurë me të cilën ato miratohen.

**Kuptimi:** Përcaktohet se si mund të ndryshohet Rregullorja e Punës.

**Rëndësia:** Ofron një mekanizëm për plotësimin e rregullores sipas nevojës.

**Si të shkruhet:** Theksohet që ndryshimet e plotësimet duhet të bëhen duke përdorur të njëjtën procedurë si miratimi fillestar.

### **Neni 19 Miratimi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli qendror/lokal rinor.

**Kuptimi:** Theksohet se kur hyn në fuqi Rregullorja e Punës.

**Rëndësia:** Sqarohet data e hyrjes në fuqi të rregullores.

**Si të shkruhet:** Specifikohet që rregullorja hyn në fuqi pas miratimit nga këshilli qendror/lokal rinor.

## SHTOJCA 6: Mostër e Planit vjetor të punës dhe buxhetit të Këshillit Qendror dhe këshillave lokalë rinor

Fusha e Fokusit	Qëllimi	Objektivat	Aktivitete	Periudha kohore	Komiteti Përgjegjës/ Personi(at)	Burimet	Rezultati i Pritur	Mjetet e verifikimit
Kjo duhet të jetë në përputhje me fushat kryesore të përcaktuara në Strategjinë për të Rinjtë (p.sh., Arsimi, Punësimi, Shëndetësia, Pjesëmarrja, etj.).	Deklaratë e përgjithshme e e asaj që këshilli dëshiron të arrijë në një fushë specifike.	Hapa specifike, të matshëm, të arritshëm, relevantë dhe të përcaktuar në kohë (SMART) që do të kontribuojnë në arritjen e qëllimit të përgjithshëm.	Veprimet specifike që do të ndërmerren për të arritur secilin objektiv.	Një orar afatesh për kur do të zbatohet secili aktivitet.	Caktohen përgjegjësitë për secilin aktivitet të një komiteti ose individit të caktuar brenda këshillit.	Buxheti për secilin aktivitet	Rezultatet e pritura të aktiviteteve. Këto duhet të jenë të matshme, sa herë që është e mundur.	Dëshmi që aktiviteti është zbatuar.
<b>A.</b> p.sh. Pjesëmarrja e të rinjve	<b>1</b> p.sh., Përforsimi i pjesëmarrjes së të rinjve në proceset e vendimarrjes lokale.	<b>1.1.</b> p.sh., të sigurohet që këndvështrimet e të rinjve të prezantohen në të paktën tri seanca të Kuvendit Komunal (KK) gjatë vitit 2026.	<b>1.1.1</b> p.sh. Përgatitja dhe dorëzimi i rekomandimeve për politika tek KK-ja për çështjet që prekin të rinjtë.	<b>Q1.</b> p.sh., Q3 - Q4, 2026	p.sh. Komiteti për Politika dhe Avokim	p.sh. Shuma fikse për Aktivitetin 1.1.1 (salla e takimit, pushimet për kafe, dreka, transporti i pjesëmarrësve, materialet)	p.sh., perspektivat e të rinjve që merren parasysh gjithnjë e më shumë si pjesë e konsultimeve për politika.	p.sh. Numri i pjesëmarrësve; Numri i rekomandimeve; Procesverbal i mbledhjes; Foto
<b>B.</b>	<b>2</b>	<b>2.1.</b>	<b>2.1.1.</b>	<b>Q3</b>	Kryetari/ja	...	...	...
<b>c.</b>	<b>3</b>	<b>3.1.</b>	<b>3.1.1.</b>	<b>Q2</b>	Nënkryetari/ja	...	...	...
...	...	...	...	...	...	...	...	...









